

## **GJYKATA E APELIT**

**Numri i lëndës: PAKR 513/2013**

**(P 50/2012 Gj/Th e Mitrovicës)**

28 maj 2014

**AKTGJYKIMI I GJYKATËS SË APELIT TË KOSOVËS, NË KOLEGJIN E PËRBËRË PREJ GJYQTARIT TË EULEX-IT MANUEL SOARES, KRYETAR DHE GJYQTAR RAPORTUES, GJYQTARIT TË EULEX-IT TORE THOMASSEN DHE GJYQTARIT DRITON MUHARREMI, SI ANËTARË TË KOLEGJIT, ME NDIHMËN E ZYRTARES LIGJORE TË EULEX-IT KERRY MOYES, E CILA VEPRON NË CILËSINË E PROCESMBAJTËSES.**

### **TË PANDEHURIT**

**M.I.**, serb;

**Z.C.**, serb;

**D.M.**, serb;

**M.R.**, serb;

**A.K.**, kosovar;

**N.J.**, serb;

### **AKTGJYKIM I GJYKATËS SË APELIT**

**Lidhur me ankesat e parashtruara ndaj aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, të datës 28 mars 2013, në lëndën nr. 50/2012, në pajtueshmëri me nenet 407-429 të KPP-së<sup>1</sup>, kolegji i Gjykatës së Apelit vendos me sa vijon:**

- 1) Hedhet poshtë si e paafatshme ankesa e parashtruara nga prokurori më 13 gusht 2013;**
- 2) Refuzohen ankesat e parashtruara nga mbrojtësi L.P. në emër të të pandehurit M.I., më 28 gusht 2013, nga mbrojtësi D.V. në emër të të pandehurit M.I., më 5 gusht 2013, dhe nga mbrojtësi F.K. në emër të të pandehurit D.M., më 1 gusht 2013 ndërsa aktgjykimi i kundërshtuar vërtetohet.**

---

<sup>1</sup> Shkurtesat në vijim të cilat u referohen kodeve përkatëse do të shfrytëzohen tash e tutje në tekst: kodi paraprak penal: KPK, kodi aktual penal: KPRK, kodi paraprak i procedurës penal: KPP-së, kodi aktual i procedurës penale: KPPK.

## ARSYETIM

### 1. Përmbledhja e procedurës përkatëse

Hetimet penale janë iniciuar nga prokuroria e UNMIK-ut më 6 qershor 2008 kundër të akuzuarve D.M., M.I., A.K. dhe Z.Č. dhe më 15 shtator 2011 kundër të akuzuarit M.R. dhe N.J.

Më 12 qershor 2012 prokurori ka ngritur aktakuzën në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës të datës 29 maj 2012.

Më 19 tetor 2012 gjyqtari konfirmues ka marrë aktvendimin mbi konfirmimin e aktakuzës.

Me aktvendimin e datës 08 janar 2013, kryetari i kolegjit ka refuzuar propozimin e prokurorit për të ftuar anëtarët e familjes të të ndjerit I.K. dhe policëve të OKB-së K., S. dhe G. si palë të dëmtuara.

Procedura e shqyrtimit gjyqësor është hapur më 26 shkurt 2012.

Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 20 mars 2013, prokurori ka ndryshuar aktakuzën.

Më 28 mars 2013 Gjykata Themelore e Mitrovicës ka dhënë aktgjykimin e kundërshtuar.

Prokurori ka parashtruar ankesë më 13 gusht 2013.

Përgjigje ndaj kësaj ankese kanë parashtruar mbrojtësit e të pandehurve D.M., M.R. dhe N.J.

Ankesat janë ushtruar nga mbrojtësi L.P. në emër të të pandehurit M.I. (28 gusht 2013), nga mbrojtësi D.V. në emër të të pandehurit M.I. (më 5 gusht 2013), dhe nga mbrojtësi F.K. në emër të të pandehurit D.M. (më 1 gusht 2013).

Prokurori ka paraqitur përgjigje në ankesat e mbrojtësve më 4 tetor 2013.

Mendimi i prokurorit të apelit është paraqitur në Gjykatën e Apelit më 5 shkurt 2014.

Seanca publike është mbajtur më 28 maj 2014.

Kolegji i Gjykatës së Apelit është këshilluar dhe ka votuar më 28 maj 2014.

Aktgjykimi me shkrim është kryer më 30 korrik 2014.

### 2. Akuzat e ngritura ndaj të pandehurve<sup>2</sup>

#### M.I.

Aktakuza: i pandehuri është akuzuar për veprat penale të *Pushtimit të paligjshëm të pronës së paluajtshme* (neni 259.1 i KPK-së), *Thirrjes për rezistencë* (neni 319 i KPK-së), *Pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 316.3 i KPK-së), *Pjesëmarrjes në grup që kryen*

---

<sup>2</sup> Ne iu kemi referuar aktakuzës së datës 12 qershor 2012 (aktakuza), aktvendimit të gjyqtarit konfirmues të datës 19 tetor 2012 (konfirmimi i aktakuzës) dhe ndryshimit të aktakuzës të datës 20 mars 2013 (ndryshimi i aktakuzës)

*vepër penale* (neni 320.1 i KPK-së), dhe *Rrezikimit të personelit të Kombeve të Bashkuara dhe të personelit në marrëdhënie me to* (neni 142.3 i KPK-së)

Konfirmimi i aktakuzës: akuza e veprës penale të *Pushtimit të paligjshëm të pronës së paluajtshme* (neni 259.1 i KPK-së) është hedhur poshtë për shkak të skadimit të afatit të parashkrimit. Aktakuza është vërtetuar për të gjitha akuzat e tjera.

Ndryshimi i aktakuzës: prokurori e ka akuzuar të pandehurin për veprat penale të *Pjesëmarrjes në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 318.1 i KPK-së), *Pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 316.3 i KPK-së), *Pjesëmarrjes në grup që kryen vepër penale* (neni 320.1 i KPK-së), dhe *Rrezikimit të personelit të Kombeve të Bashkuara dhe të personelit në marrëdhënie me to* (neni 142.3 i KPK-së). Vepra penale e *Thirrjes për rezistencë* (neni 319 i KPK-së) e ngarkuar në aktakuzë dhe e konfirmuar nga gjyqtari konfirmues nuk është përmendur në kërkesën për ndryshimin e aktakuzës.

## **Z.C.**

Aktakuza: i pandehuri është akuzuar për veprat penale të *Pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 316.3 i KPK-së), *Pjesëmarrjes në grup që kryen vepër penale* (neni 320.1 i KPK-së), dhe *Rrezikimit të personelit të Kombeve të Bashkuara dhe të personelit në marrëdhënie me to* (neni 142.3 i KPK-së).

Konfirmimi i aktakuzës: aktakuza është konfirmuar për të gjitha akuzat.

Ndryshimi i aktakuzës: prokurori e ka akuzuar të pandehurin sikurse në aktakuzë për veprat penale të *Pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 316.3 i KPK-së), *Pjesëmarrjes në grup që kryen vepër penale* (neni 320.1 i KPK-së), dhe *Rrezikimit të personelit të Kombeve të Bashkuara dhe të personelit në marrëdhënie me to* (neni 142.3 i KPK-së).

## **D.M.**

Aktakuza: i pandehuri është akuzuar për veprat penale të *Pushtimit të paligjshëm të pronës së paluajtshme* (neni 259.1 i KPK-së), *Dëmtimit të pasurisë së luajtshme* (neni 260.1 i KPK-së), *Pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 316.3 i KPK-së), *Pjesëmarrjes në grup që kryen vepër penale* (neni 320.1 i KPK-së) dhe *Rrezikimit të personelit të Kombeve të Bashkuara dhe të personelit në marrëdhënie me to* (neni 142.3 i KPK-së).

Konfirmimi i aktakuzës: akuzat për veprat penale të *Pushtimit të paligjshëm të pronës së paluajtshme* (neni 259.1 i KPK-së) dhe *Dëmtimit të pasurisë së luajtshme* (neni 260.1 i KPK-së), janë hedhur poshtë për shkak të skadimit të afatit të parashkrimit. Aktakuza është vërtetuar për të gjitha akuzat e tjera.

Ndryshimi i aktakuzës: prokurori e ka akuzuar të pandehurin për veprat penale të *Pjesëmarrjes në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 318.1 i KPK-së), *Pjesëmarrjes në grup që kryen vepër penale* (neni 320.1 i KPK-së) dhe *Rrezikimit të personelit të Kombeve të Bashkuara dhe të personelit në marrëdhënie me to* (neni 142.3 i KPK-së). Akuza e

*Pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 316.3 i KPK-së), është tërhequr nga prokurori.

#### **M.R.**

Aktakuza: i pandehuri është akuzuar për veprat penale të *Pjesëmarrjes në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 318.2 i KPK-së), *Pjesëmarrjes në grup që kryen veprë penale* (neni 320.1 i KPK-së), *Pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 316.3 i KPK-së), dhe *Nxitjes së urrejtjes, të përçarjes ose të mosdurimit kombëtar, racor, fetar a etnik* (neni 115.1 i KPK-së),

Konfirmimi i aktakuzës: akuza e veprës penale të *Pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 316.3 i KPK-së), është hedhur poshtë sepse gjyqtari konfirmues ka konsideruar se kjo veprë penale reciprokisht përjashtohet me veprën e bashkuar penale të *Pjesëmarrjes në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 318.2 i KPK-së). Aktakuza është vërtetuar për të gjitha akuzat e tjera.

Ndryshimi i aktakuzës: prokurori e ka akuzuar të pandehurin për veprën penale të *Thirrjes për rezistencë* (neni 319 i KPK-së). Veprat penale të ngarkuara në aktakuzë dhe të konfirmuara nga gjyqtari konfirmues, nuk janë përmendur në kërkesën e prokurorit për ndryshimin e aktakuzës.

#### **A.K.**

Aktakuza: i pandehuri është akuzuar për veprat penale të *Pjesëmarrjes në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 318.1 i KPK-së), *Pjesëmarrjes në grup që kryen veprë penale* (neni 320.1 i KPK-së), *Pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 316.3 i KPK-së), *Rrezikimit të personelit të Kombeve të Bashkuara dhe të personelit në marrëdhënie me to* (neni 142.3 i KPK-së) dhe *Sulmit ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare* (neni 317.1 i KPK-së),

Konfirmimi i aktakuzës: akuza për *Pjesëmarrje në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 318.2 i KPK-së) është hedhur poshtë sepse gjyqtari konfirmues ka konsideruar se kjo veprë penale reciprokisht përjashtohet me veprën e bashkuar penale të *Pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 316.3 i KPK-së). Aktakuza është vërtetuar për të gjitha akuzat e tjera.

Ndryshimi i aktakuzës: prokurori e ka akuzuar të pandehurin sikurse në aktvendimin për konfirmim për *Pjesëmarrje në grup që kryen veprë penale* (neni 320.1 i KPK-së), *Pengim të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 316.3 i KPK-së), *Rrezikim të personelit të Kombeve të Bashkuara dhe të personelit në marrëdhënie me to* (neni 142.3 i KPK-së) dhe *Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare* (neni 317.1 i KPK-së).

#### **N.J.**

Aktakuza: i pandehuri është akuzuar për veprat penale të *Pjesëmarrjes në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 318.2 i KPK-së), *Pjesëmarrjes në grup që kryen veprë penale* (neni 320.1 i KPK-së), *Pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 316.3 i KPK-së).

Konfirmimi i aktakuzës: akuza për *Pengim të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 316.3 i KPK-së) është hedhur poshtë sepse gjyqtari konfirmues ka konsideruar se kjo veprë penale reciprokisht përjashtohet me veprën e bashkuar penale të *Pjesëmarrjes në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 318.2 i KPK-së). Aktakuza është konfirmuar për të gjitha akuzat e tjera.

Ndryshimi i aktakuzës: akuzat ndaj këtij të pandehuri nuk janë përmendur në kërkesën e prokurorit për ndryshimin e aktakuzës.

### **3. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë**

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur për akuzat si më poshtë:

#### **M.I.**

Ky i pandehuri është dënuar për (1) *Pengim të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 316.3 i KPK-së) me 6 muaj burgim, (2) *Pjesëmarrje në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 318.1 i KPK-së) me 4 muaj burgim, (3) *Pjesëmarrje në grup që kryen veprë penale* (neni 320.1 i KPK-së) me 6 muaj burgim, dhe për (4) *Rrezikim të personelit të Kombeve të Bashkuara dhe të personelit në marrëdhënie me to* (neni 142.2 i KPK-së) me 1 vit e 6 muaj burgim. Dënimi unik i caktuar është 1 vit e 10 muaj burgim.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se më 17 mars 2008 në Mitrovicë para orës 7.00 të mëngjesit, në kryqëzimin në mes të rrugës ‘Filip Višnjića’, ku gjendet edhe gjykata e Mitrovicës, dhe rrugës që shpie në Zveçan, disa metra përtej portës në veri të kompleksit të gjykatës, i pandehuri ka hedhur një gur të madh me përmasa dore ose një gjësend të fortë me përmasa të njëjta në drejtim të një grupi të zyrtarëve policor të Kombeve të Bashkuara dhe ushtarëve të KFOR-it dhe me të ka goditur mburojën e njërit prej policëve. Para se ta bënte këtë, ai, me një shishe ka hedhur lëng të tejdukshëm në drejtim të policëve të përmendur më sipër. Ai ka vepruar brenda një grupi që kishte të paktën 20 persona të cilët përballeshin me vijën e parë të policëve; anëtarët e grupit kanë hedhur gurë të mëdhenj me përmasa të dorës dhe guralecë dhe një zinxhir të gjatë metali në kordonin e policisë/KFOR-it gjë e cila ka krijuar një rrezik të përgjithshëm për policët e përfshirë dhe rrezik të rëndë për përshkallëzim të situatës që rrjedhimisht ndodhi më pas. Veprimet e tij dhe veprimet e anëtarëve të grupit i kanë penguar forcat zyrtare që në mënyrë të sigurt ta shoqërojnë kolonën e OKB-së me rreth 50 protestues të cilët ishin arrestuar më parë në gjykatë dhe të cilët është dashur të transportoheshin në Prishtinë. Ky grup, me pjesëmarrjen e të pandehurit, së bashku i kanë penguar forcat e OKB-së dhe të

KFOR-it në përpjekjet e tyre për ta ruajtur dhe rivendosur një ambient të sigurt dhe rend publik, gjë të cilën ai edhe e kishte për qëllim. I pandehuri e ka ditur se me praninë e vet dhe veprimet e veta pjesëmarrëse edhe ai e ka mbështetur këtë turmë në veprimet e saj dhe e ka inkurajuar të veprojë në asi mënyre. Ai ishte i vetëdijshëm për rrezikun se gjendja mund të përshkallëzohet gjë e cila nuk e ndaloi atë nga të vepruarit ashtu sikurse edhe bëri. Në atë kohë gjykata ishte nën administrimin e UNMIK-it sipas Rezolutës 1244 të OKB-së.

Në aktgjykim, gjithashtu, është vërtetuar se pikërisht në mëngjesin e datës 17 mars 2008, me t'u mbledhur turma prej qindra personave rreth orës 10.15 paradite, i pandehuri ka vrapuar poshtë e lart në pjesën e rrugës përballë gjykatës dhe ka bërë lëvizje të duarve duke i tundur në drejtim të turmës. Ai ka hedhur edhe gurë ose dru. Kjo ndodhi pasi tashmë ishin hedhur disa granata të dorës në forcat e OKB-së dhe KFOR-it dhe pasi që një granatë e dorës e kishte goditur policin ukrainas të OKB-së I.K. rreth orës 8 të mëngjesit të të njëjtës ditë. I.K. ka vdekur si rezultat i lëndimeve të tij të rënda në mbrëmjen e ditës kritike rreth orës 22.00. Ka pasur sulme të shumta me granata të dorës dhe zjarr nga AK 47 prej turmës, si edhe gaz lotsjellës të hedhur nga KFOR-i. Nga të dyja anët, edhe nga ana e protestuesve edhe nga ana ndërkombëtare kanë qenë më shumë se 100 persona të lënduar, disa nga ta kanë qenë të lënduar shumë rëndë. Një autobus dhe vetura të OKB-së janë djegur nga turma. Turma kishte arritur t'i liroj të arrestuarit duke sulmuar kolonën. Me praninë e tij në vendin e ngjarjes pas hedhjes së gazit lotsjellës, i pandehuri e dinte se nuk ishte duke u zhvilluar një protestë paqësore, por një tepër e dhunshme e cila epilog kishte rrezikun e menjëhershëm për jetë dhe integritet trupor të forcave të OKB-së dhe KFOR-it dhe të personave të tjerë të pranishëm e edhe dëm të konsiderueshëm material. Prapë se prapë ai nuk u distanca, por i pranoi këto pasoja.

I pandehuri është liruar nga (1) *Pjesëmarrja në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare*, për veprimet më 14 mars (neni 318.1 i KPK-së), (2) *Thirrje për rezistencë*, për veprimet më 17 mars (neni 319 i KPK-së) dhe (3) *Rrezikim të personelit të Kombeve të Bashkuara dhe të personelit në marrëdhënie me to*, për veprimet më 17 mars (neni 142.3 i KPK-së).

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se nuk është provuar që i pandehuri më 14 mars 2008, në mëngjesin e hershëm, ishte tanimë i pranishëm dhe aktivisht i përfshirë në ndonjë veprim të turmës e cila po shkatërronte portën e gjykatës, dhe e cila e ka shfrytëzuar rrethojën si mburojë kundër policëve të OKB të pranishëm aty, e më pas, pa leje, kanë hyrë në ndërtesën e gjykatës për ta zënë atë. Në favor të të pandehurit, është gjetur se ai ka arritur vetëm më vonë, kur mësymja në ndërtesën e gjykatës kishte përfunduar dhe një grup personash ishin tashmë brenda ndërtesës; më pas ai u ngjiti në çatinë e ndërtesës dhe ndërhyri në flamurin e OKB-së.

Gjithashtu nuk është provuar se i pandehuri ishte i përfshirë në organizimin dhe drejtimin e ambulancave të cilat më 17 mars 2008 rreth orës 6.30 në mëngjes ishin duke shkuar poshtë e lart rrugës 'King Peter' me sirena të lëshuara, me qëllim që ta alarmonin komunitetin serb për tu grumbulluar e për ta ndaluar kolonën e OKB-së për të shkuar në Prishtinë dhe se në orën 6.41 të mëngjesit ai i ka shfrytëzuar sirenat për ta bërë këtë. Më tutje, aktgjykimi ka vërtetuar se nuk

është provuar se më 17 mars 2008, i pandehuri ka marrë pjesë në një sulm të dhunshëm në vet ndërtesën e gjykatës, e as në automjetet e OKB-së, që me gjasë do ta rrezikonte një anëtar të personelit të OKB-së sepse është provuar se veprimet për të cilat ishte shpallur fajtor kishin ndodhur jashtë portës veriore dhe jo në kompleksin e ndërtesës së gjykatës dhe ishte drejtuar kundër personelit të OKB-së jashtë ndërtesës e jo brenda saj. Sa u përket automjeteve të djegura dhe të sulmuara të OKB-së, nuk është provuar se i pandehuri ishte i përfshirë në veprime të tilla.

## Z.Č.

Ky i pandehur është dënuar për (1) *Pengim të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 316.3 i KPK-së) me 2 muaj burgim, (2) *Pjesëmarrje në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 318.1 i KPK-së) me 1 muaj burgim, (3) *Pjesëmarrje në grup që kryen veprë penale* (neni 320.1 i KPK-së) me 2 muaj burgim dhe (4) *Rrezikim të personelit të Kombeve të Bashkuara dhe të personelit në marrëdhënie me to* (neni 142.2 i KPK-së) me 8 muaj burgim. Dënimi unik është 9 muaj burgim me kusht, në periudhë verifikimi prej 1 viti.

Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se më 17 mars 2008 para orës 7.00 të mëngjesit, në kryqëzimin në mes të rrugës 'Filip Višnjića' dhe rrugës që shpie në drejtim të Zvečanit, disa metra përtej portës në veri të kompleksit të gjykatës së Mitrovicës, i pandehuri duke qenë pjesë e turmës prej së paku 20 personave në të cilën ishte i pranishëm edhe i pandehuri i parë dhe kur personat në turmë hodhën guralecë dhe një zinxhir të gjatë metali në kordonin e policisë/KFOR-it, i pandehuri hodhi një shkop me gjatësi rreth 20-30 cm, të cilën ai në mënyrë spontane e mori nga toka, nga një distance më pak se 5 m, në një hark kundër policëve të përmendur më sipër të cilët e ruanin kolonën e transportit të protestuesve në Prishtinë dhe të cilët ishin duke e ruajtur rendin dhe sigurinë publike. Edhe pse policët ishin me pancirë dhe me mburojë, dhe nuk ka mundur të provohet se dikush ishte lënduar në këtë fazë, veprimet e përbashkëta të grupit me gjasë do të qonin në përshkallëzim të gjendjes dhe shkaktim të rrezikut të përgjithshëm për forcat e përfshira ndërkombëtare. Më vonë, pas orës 7.00 të mëngjesit, disa persona janë lënduar dhe një polic i OKB-së ka vdekur. Pas 5 sekondash, ende para orës 7.00 paradite të së njëjtës ditë, në të njëjtin vend, ai kishte hedhur shkopin e dytë me gjatësi prej 30 cm, të cilin spontanisht e mori nga toka, në drejtim të forcave ndërkombëtare. Duke e bërë këtë, ai e goditi mburojën e njërit nga pjesëtarët të forcave mbrojtëse të OKB/KFOR-it.

Në aktgjykim po ashtu është vërtetuar se grupi dhe i pandehuri në një veprim të përbashkët i ka penguar forcat ndërkombëtare në përcjelljen dhe mbrojtjen e kolonës së protestuesve, dhe i ka penguar ata në ruajtjen dhe rivendosjen e sigurisë dhe rendit publik. Pastaj ai ka ikur dhe ka qëndruar për rreth 10 sekonda në vendin e ngjarjes. Ai ka vepruar në mënyrën e përshkruar më sipër duke e ditur se ai, edhe individualisht dhe si pjesë e grupit, i ka penguar forcat zyrtare për ta përcjellë në mënyrë të sigurt kolonën e OKB-së dhe për ta ruajtur sigurinë dhe rendin publik dhe e pranoi atë. Më tutje, ai e dinte se me praninë e tij dhe veprimet e veta pjesëmarrëse ai po mbështeste edhe turmën e pranishme në veprimet e saj, dhe i inkurajoi ata që të vazhdojnë ta bëjnë të njëjtën.

Ai ishte i vetëdijshëm për rrezikun që situata kishte shkaktuar rrezik të madh, mund të përshkallëzohej dhe e pranoi atë.

I pandehuri është liruar nga vepra penale e *Rrezikimit të personelit të Kombeve të Bashkuara dhe të personelit në marrëdhënie me to*, për veprimet më 17 mars (neni 142.3 i KPK-së).

Gjykata e shkallës së parë ka gjetur si jo të provuar se i pandehuri ishte ende në turmë, në veçanti, pas orës 7.00 të mëngjesit kur ishte hedhur granata e parë e dorës dhe kur një granatë dore e qëlloi policin e ndjerë të OKB-së I.K. rreth orës 8.00 të mëngjesit e që ka shkaktuar vdekjen e tij më vonë dhe kthim tepër të dhunshëm të gjendjes. Nuk është gjetur as se i pandehuri ka marrë pjesë në një sulm të dhunshëm në ndërtesën e gjykatës e as se ai ka marrë pjesë në sulmet mbi automjetet e OKB-së të cilat kanë mundur ta rrezikojnë një pjesëtar të personelit të OKB-së, sepse veprimet për të cilat ai ishte shpallur fajtor kishin ndodhur jashtë portës veriore e jo në kompleksin e ndërtesës së gjykatës dhe ishin drejtuar kundër personave e jo kundër ndërtesës së gjykatës apo automjeteve të OKB-së. Për shkak të këtyre arsyeve, nuk ka mundur të provohet se i pandehuri ka qenë i pranishëm në një fazë të mëvonshme kur u dëmtuan dhe u dogjën veturat e OKB-së.

## **D.M.**

Ky i pandehur është dënuar për (1) *Pengim të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 316.3 i KPK-së) me 4 muaj burgim, (2) *Pjesëmarrje në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 318.1 i KPK-së) me 2 muaj burgim, (3) *Pjesëmarrje në grup që kryen veprë penale* (neni 320.1 i KPK-së) me 4 muaj burgim dhe (4) *Rrezikim të personelit të Kombeve të Bashkuara dhe të personelit në marrëdhënie me to* (neni 142.2 i KPK-së), me 1 vit e 3 muaj burgim. Dënimi unik është 1 vit e 6 muaj burgim.

Në aktgjykim është provuar se në mëngjesin e datës 17 mars 2008 i pandehuri është arrestuar nga policët ndërkombëtar të UNMIK-ut derisa ishte brenda ndërtesës së gjykatës së Mitrovicës. Derisa ka qenë në një furgon të UNMIK-ut që udhëtonte si pjesë e një kolone të gjatë të automjeteve me të arrestuarit e tjerë, ai u lirua pasi kolona ishte sulmuar nga një turmë. Pasi ka rifiturar lirinë e vet, ai nuk u kthye në shtëpi, por ka mbetur në vendin e ngjarjes. Atje ai iu bashkua grupit prej jo më pak se 30 persona të cilët ishin mbledhur në kryqëzimin e rrugës ‘Filip Višnjića’ dhe rrugës që shpie në drejtim të Zveçanit, jashtë portës veriore të gjykatës. Ai arriti të marrë për vete një maskë gazi në mënyrë që të mbrohej nga gazi lotsjellës që tashmë ishte hedhur. Personat në grup hodhën jo më pak se një koktej Molotovi dhe gurë në drejtim të trupave të OKB-së dhe të KFOR-it të cilët ishin në rrugë në afërsi të portës së veriut. Edhe i pandehuri vet ka marr një gur për tu përgatitur që ta hidhte kundër forcave të pranishme ndërkombëtare. Afër udhëkryqit ai e shkelmoi derën e një automjeti të zbrazët ‘Hyundai’ të OKB-së (ka mbetur e paqartë nëse dera kishte qenë e dëmtuar më parë). I pandehuri ka vepruar në mënyrën e lartpërmendur pasi që ishte hedhur granatë e parë e dorës pas orës 07:00 të mëngjesit dhe hedhjes së gazit lotsjellës, kur u hap zjarr dhe kur trazirat u bënë shumë të dhunshme dhe shkaktuan lëndime të shumta në të dy anët, në anën e protestuesve dhe në anën e forcave ndërkombëtare. Polici i OKB-së I.K. më vonë, në orën 22.00 vdiq për shkak të lëndimeve të tij. Ushtarët e KFOR-it dhe policët e UNMIK-ut janë



përpjekur për ta siguruar transportin e të arrestuarve në një kolonë për në Prishtinë dhe për ta rivendosur rendin dhe sigurinë publik. I pandehuri e ka ditur se me praninë e tij dhe veprimet e veta pjesëmarrëse ai po përkrahte edhe turmën e pranishme në veprimet e saj, dhe e inkurajoi atë që të vazhdojë ta bëjë të njëjtën. Ai ishte i vetëdijshëm për rrezikun që situata, e cila tashmë ishte jashtëzakonisht e dhunshme, do të mund të përshkallëzohej më tej dhe e pranoi atë.

I pandehuri ishte liruar nga vepra penale e (1) *Pjesëmarrjes në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare*, për veprimet më 14 mars (neni 318.1 i KPK-së) dhe (2) *Rrezikim të personelit të Kombeve të Bashkuara dhe të personelit në marrëdhënie me to*, për veprimet më 17 mars (neni 142.3 i KPK-së).

Është vërtetuar si jo e provuar se më 14 mars 2008, i pandehuri ishte pjesë e një turme të madhe njerëzish të cilët u mblodhën në portën kryesore të ndërtesës së gjykatës dhe e hoqën atë dhe pastaj e detyruan rrugën e saj në perimetrin e brendshme të oborrit të gjykatës. Po ashtu, nuk është vërtetuar se ai ishte pjesë e turmës, kur, pas heqjes së portave, këto porta janë përdorur si mburojë për t'i shtyrë prapa policët ndërkombëtarë të UNMIK-ut që ishin duke ruajtur rendin dhe sigurinë publike. Në favor të të pandehurit ka qenë e mundshme të provohet vetëm se në një moment më 14 mars 2008 ai ka hyrë në ndërtesën e gjykatës dhe e ka hequr flamurin e OKB-së nga ballkoni i ndërtesës, dhe është gjetur brenda ndërtesës së gjykatës më 17 mars 2008 kur edhe u arrestua.

Më tutje, gjykata e shkallës së parë nuk e ka konsideruar të provuar se i pandehuri është përfshirë në një sulm në ndërtesën e OKB-së sepse sulmi i përmendur më sipër i turmës në të cilën ai ishte pjesëmarrës ishte drejtuar kundër personave të OKB-së dhe jo kundër vet gjykatës. Nuk ka mundur të provohet se ai, kur e ka shkëluar derën e djathtë të veturës 'Hyundai', ka rrezikuar UNMIK-un dhe personelin shoqërues e edhe lirinë e tyre për shkak se vetura ishte pa askënd brenda dhe për këtë arsye nuk ka qenë e mundshme që personeli i OKB-së të ishte në rrezik. Kur u sulmua automjeti në të cilin ai qëndronte si i arrestuar, ai ishte brenda automjetit dhe nuk ishte i përfshirë në atë sulm.

## **M.R.**

I pandehuri është liruar nga veprat penale të (1) *Nxitjes së urrejtjes, të përçarjes ose të mosdurimit kombëtar, racor, fetar a etnik* (neni 115.1 i KPK-së), (2) *Thirrjes për rezistencë* (neni 319 i KPK-së), (3) *Pjesëmarrjes në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 318.2 i KPK-së), dhe (4) *Pjesëmarrjes në grup që kryen vepër penale* (neni 320.1 i KPK-së),

Edhe pse është provuar se diku në mes të 29 shkurt 2008 dhe 14 mars 2008, i pandehuri në praninë e dëshmitarëve M. dhe D. në një lokacion të panjohur, e ka thënë fjalinë "do të vijë me 250.000 serb për ta marrë nën kontroll gjykatën dhe ata do të vdesin njëri pas tjetrit për ta marrë hyrjen", dhe ka mundur të dëgjohet nga serbët e pranishëm, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se ai e ka thënë këtë fjali vetëm spontanisht gjatë shpërthimit të zemërimit pasi që atij i është thënë se gjykata do të ishte nën kontrollin e Ministrisë së Drejtësisë të Kosovës, por që nuk ishte fjalim i përgatitur për serbët dhe nuk e kishte këtë qëllim, nuk është përsëritur në mënyrë që ta bëjë porosinë e qartë, dhe nuk kishte për qëllim që të shkaktojë seriozisht ndjenjë

urrejtjeje nacionale ose etnike në mesin e të pranishmëve. Po ashtu nuk është vërtetuar se fjalia ka shkaktuar ndonjë reagim në mesin e personave që mundë ta kenë dëgjuar atë. Nuk është vërtetuar se i pandehuri ka pohuar të ketë ndonjë ndikim të madh në ardhjen e një numri aq të madh dhe joreal të serbëve dhe në statusin politik dhe administrativë të gjykatës si të tillë.

Në aktgjykim është vërtetuar si jo e provuar se i pandehuri më 17 mars 2008 në Mitrovica me të pandehurin N.J., duke ndjekur apo duke mos ndjekur një plan të përbashkët, kanë drejtuar dy kamion të bardhë mbeturinash dhe një cisternë për t'i vënë në portën kryesore me qëllim që ta bllokojnë stacionin policor të Mitrovicës së veriut për ta parandaluar kolonën e OKB-së me protestuesit e arrestuar që të dalin nga kompleksi për të shkuar në Prishtinë, dhe për t'i penguar forcat ndërkombëtare që përpiqeshin për të mbrojtur dhe për të ruajtur sigurinë dhe rendin publik. Po ashtu nuk është provuar se po të njëjtën ditë i pandehuri ishte i pranishëm në ndërtesën e gjykatës dhe në rrethinën e saj kur një turmë e madhe ishte mbledhur dhe kishte penguar një kolonë të OKB-së që kishte persona të arrestuar e që përpiqej të voziste për në Prishtinë. Nuk është gjetur se ai ishte i pranishëm në ndërtesën e gjykatës atë ditë kur turma e lartë përmendur ka hedhur gjësendet, përfshirë granatat e dorës dhe mjetet shpërthyesë në drejtim të policëve të OKB-së dhe ushtarëve të KFOR-it, që shkaktoi një numër lëndimesh dhe vdekjen e policit ukrainas I.K., ose që ai ishte i përfshirë në planifikimin e grumbullimit të turmës ose që ai kishte ndonjë rol si udhëheqës në përgatitjen e trazirave më 17 mars 2008.

#### **A.K.**

I pandehuri është liruar nga veprat penale të (1) *Pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 316.3 i KPK-së), (2) *Sulmit ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare* (neni 317.1 i KPK-së), (3) *Pjesëmarrjes në grup që kryen vepra penale* (neni 320.1 i KPK-së), dhe (4) *Rrezikimit të personelit të Kombeve të Bashkuara dhe të personelit në marrëdhënie me to* (neni 142.2 i KPK-së).

Nuk është vërtetuar se në mëngjesin e datës 17 mars 2008, në Mitrovicë derisa ka qenë në një grup ishte i pandehuri dhe jo personi i tretë ai i cili ka shtuar edhe një gomë në një bllokim tashmë të djegur rruge në afërsi të ndërtesës së gjykatës së Mitrovicës e po ashtu nuk është vërtetuar as se ai ka hedhur së paku një gjësend drejt vijës dhe kordonit të sigurisë së ushtarëve të KFOR-it të cilët po e ruanin ndërtesën e gjykatës nga trazirat që zhvilloheshin e që filluan pikërisht në ditën pasi që personeli i OKB-së kishte arrestuar protestuesit në ndërtesën e gjykatës së Mitrovicës.

#### **N.J.**

I pandehuri është liruar nga veprat penale të (1) *Pjesëmarrjes në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 318.2 i KPK-së) dhe (2) *Pjesëmarrjes në grup që kryen vepra penale* (neni 320.1 i KPK-së),

Nuk është konstatuar e vërtetuar se më 17 mars 2008 në Mitrovicë, bashkë me të pandehurin M.R., duke ndjekur apo duke mos ndjekur një plan të përbashkët, dhe duke qenë pjesë e grupit, ai ka drejtuar dy kamionë të mëdhenj të bardhë dhe një cisternë me qëllim që t'i vendosë në portën kryesore të ndërtesës së gjykatës për ta parandaluar kolonën me rreth 50 persona, të cilët ishin arrestuar atë ditë nga policia e OKB-së në ndërtesën e gjykatës, që po dilnin nga kompleksi dhe vozisnin në drejtim të Prishtinës, ose që ai ishte i përfshirë në planifikimin e trazirave ose që pati rol udhëheqës në përgatitjen apo ekzekutimin e sulmit në personelin e OKB-së dhe KFOR-it në trazirat e datës 17 mars 2008.

#### 4. Parashtrësia e palëve

Prokurori ka ankimuar aktgjykimin, duke kundërshtuar lirimet dhe dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurve – duke i konsideruara shumë të buta – dhe ka kërkuar që Gjykata e Apelit ta ndryshojë aktgjykimin duke i rritur dënimet dhe dënuar të pandehurit e liruar. Përgjigje në këtë ankesë kanë parashtruar mbrojtësit e të pandehurve D.M., M.R. dhe N.J. Për arsye të cilat do të theksohen më poshtë, ankesa e prokurorit është parashtruar me vonesë dhe duhet të hedhet poshtë. Është e panevojshme të bëhet përmbledhja e përmbajtjes së ankesës, përgjigjeve përkatëse dhe propozimit të prokurorit të apelit.

Mbrojtësi i të pandehurit M.I. ka parashtruar ankesë në të cilën shkruhet se ka pasur shkelje të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabueshëm të fakteve dhe vendim të gabueshëm mbi dënimin. Ai sugjeron në mënyrë alternative që lënda të kthehet në Gjykatën Themelore në rigjykim, që ai të lirohet nga të gjitha akuzat ose t'i shqiptohet një dënim më i butë.

Lidhur me shkeljet e procedurës penale, ai pohon se aktgjykimi është në kundërshtim me veten. Në faqen e parë, i pandehuri akuzohet për pesë vepra penale; megjithatë, në dispozitiv ai është dënuar për katër vepra penale dhe i liruar nga tri vepra. Më tej, ai ka pohuar se edhe është dënuar edhe është liruar për të njëjtën vepër (*Rrezikim i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe të personelit në marrëdhënie me to*) në kundërshtim me nenin 241.3 të KPP-së. Njëherazi ai ka pohuar se aktgjykimi ka tejkalluar aktakuzën sepse prokurori e ka ndryshuar aktakuzën më 20 mars 2013, por gjykata e ka shtuar e nuk e ka zëvendësuar atë në vendosjen e saj. Së fundi, ai ka kontestuar vlefshmërinë e regjistrimit fotografik dhe me video si prova të pranueshme, për arsye se ato janë të pa mbështetshme dhe me origjinë të panjohur.

Lidhur me vërtetimin e gabueshëm të gjendjes faktike, parashtruesi i ankesës ka pohuar se nuk mund të mbështetmi me siguri absolute në video regjistrim për ta treguar të pandehurin. Ai më tej ka shtuar se dëshmitari R.D. nuk e ka treguar të vërtetën lidhur me të pandehurin. Ai fillimisht ka thënë se nuk e ka parë atë më 17 mars 2008 por dy ditë më vonë tha se e ka parë dhe solli shumë detaje. Nuk është dhënë asnjë shpjegim përveç asaj se kujtesa e tij u kthye pasi e rifreskoi atë. Pastaj siç është shfaqur nga një vizitë e bërë terrenit, nuk e ka qenë e mundshme

për te t'i ketë parë me sy ngjarjet nga ballkoni i stacionit policor të veriut ashtu siç ka dëshmuar në dëshminë e vet. Ai po ashtu ishte jo i besueshëm në pohimin se ishin përdorur mortajat.

Parashtruesi i ankesës ka kundërshtuar dënimin e përcaktuar, duke pohuar se vlerësimi i faktorëve rënduese ishte jo korrekt. Është deklaruar se ishte shkaktuar dëm material por nuk ka prova që ai e ka shkaktuar një dëm të tillë. 'Roli aktiv' i tij në ngjarjet e datës 14 mars 2008 nuk mund të jetë një faktor rëndues pasi që ai nuk është dënuar për asnjë vepër të asaj dite. Ai, po ashtu, ka pohuar se jo të gjitha rrethanat lehtësuese janë vlerësuar. Gjatë procedurës, ai ka pasur sjellje të shkëlqyeshme...

Mbrojtësi i të pandehurit Z.Č. ka ushtruar ankesë por parashtresa e tij nuk përmban hollësira përveç asaj se aktgjykimi është vërtetuar në mënyrë të gabueshme dhe jo të plotë sipas nenit 386 të KPP-së, dhe se është bazuar në xhirime të cilat janë të papranueshme. Ai, ia referon Gjykatës së Apelit procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor dhe fjalën e tij përfundimtare. Propozimi i tij është që lënda të kthehet në Gjykatën Themelore në rigjykim ose që i pandehuri të lirohet nga të gjitha akuzat.

Së fundi, ankesë është ushtruar nga mbrojtësi i të pandehurit D.M. Ai pohon se ka pasur shkelje të procedurës penale, vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendim të gabuar mbi sanksionin penal. Ai ka propozuar që i pandehuri të lirohet nga të gjitha akuzat ose që lënda të kthehet në Gjykatën Themelore në rigjykim ose së paku, të shqiptohet një dënim më i butë.

Sipas mendimit të këtij parashtruesi të ankesës, aktgjykimi i shkallës së parë është në kundërshtim me rregullat e procedurës penale të nenit 384 1.10, 1.12 dhe 2.1 të KPP-së. Dispozitivi është i pakuptueshëm dhe kundërthënës. Më 20 mars 2013, prokurori ka ngritur aktakuzën e ndryshuar duke e akuzuar të pandehurin me vetëm dy vepra penale: *Pjesëmarrje në grup që kryen vepra penale* dhe *Rrezikim të personelit të OKB-së*. Me aktakuzën e ndryshuar prokurori ka tërhequr dy akuza lidhur me *Pengimin e personit zyrtar*. Në këtë mënyrë ai ishte akuzuar për dy vepra penale por ishte dënuar për katër vepra penale. Po ashtu është pohuar se aktgjykimi nuk përmban arsye për vërtetimin e fakteve. Për më tepër ai pohon se gjykata ka bazuar vendimin e vet ekskluzivisht në fotografi dhe xhirime pa i ditur kush i ka filmuar ato, gjë që i bën provat të papranueshme.

Vërtetimi i gabueshëm i kundërshtuar i gjendjes faktike qëndron në mungesën e pohuar të provave. Ishte gabim i gjykatës të pohonte se mbrojtësi nuk ka pohuar në mënyrë të qartë se cilat dokumente ai i ka kundërshtuar dhe pse. Kjo është pjesërisht detyrë e trupit gjykues.

Lidhur me vërtetimin e gabueshëm të dënimit, parashtruesi i ankesës ka pohuar se gjykata nuk i ka marrë parasysh siç duhet rrethanat lehtësuese: moshën e të pandehurit, mospasjen e dënimeve në të kaluarën, se familja e tij është në gjendje të dobët materiale, papunësia, dhe se veprat penale kanë ndodhur më shumë se 5 vjet më parë dhe se ai nuk ka kryer asnjë vepër tjetër gjatë kësaj periudhë.

Prokurori ka parashtruar përgjigje ndaj ankesave të mbrojtësve me sa vijon:

#### Ankesa e M.I.:

Shkelja e procedurës penale: ndryshimi i aktakuzës vetëm i zgjeron faktet në hollësi për secilin të pandehur dhe nuk ndikon në vlefshmërinë e aktakuzës fillestare; provat e paraqitura në lidhje me video xhirimet dhe fotografitë janë të pranueshme.

Vërtetim i gabueshëm i gjendjes faktike: i pandehuri, në mënyrë të qartë, është i dallueshëm dhe i identifikueshëm në video dhe në fotografi. Asnjëherë nuk është thënë se ato ishin të kualitetit të dobët dhe ai është identifikuar në to nga dëshmitarët e prokurorisë D. dhe M. Gjykata Themelore nuk i ka gjetur provat e dëshmitarit R.D. të pasakta ose me të meta, dhe asnjëherë nuk ka deklaruar se ai ka gënjer ose në ndonjë mënyrë ka cenuar besueshmërinë e tij në gjetjet e veta.

Vërtetim i gabueshëm i dënimit: të gjitha rrethanat lehtësuese të përmendura në ankesë janë shqyrtuar nga Gjykata e Apelit.

#### Ankesa e Z.Č.:

Prokurori vëren se kjo ankesë në mënyrë përmbledhëse përmban se vërtetimi i gjendjes faktike është i gabueshëm dhe jo i plotë sipas nenit 386 të KPP-së.

#### Ankesa e D.M.<sup>3</sup>:

Shkelja e procedurës penale: lidhur me rregullat në nenin 7 të KPP-së, kur është marrë aktgjykimi janë sjellë të dhëna të plota dhe të përpikta dhe prokuroria plotësisht ka respektuar kushtet e kësaj dispozite. Sa i përket akuzës së *Pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare*, gjykata e ka vendosur këtë çështje sipas nenit 363 të KPP-së sikurse edhe është shkruar në aktakuzën e ndryshuar. Të gjitha provat e parashtruara janë të pranueshme sepse të njëjtat janë në përputhshmëri me rregullat e provave sikurse parashihet me kodin e procedurës penale.

Vërtetim i gabueshëm i gjendjes faktike: xhirimi dhe fotografitë, duke qenë prova të pranueshme, në mënyrë të qartë tregojnë çfarë kanë bërë të gjithë të pandehurit atë ditë. Kjo provë është vërtetuar me dëshminë gojore të dëshmitarëve të prokurorisë D. dhe M., e edhe nga deklaratat e dëshmitarëve dhe raportet e paraqitura nga policia.

Prokurori i apelit ka parashtruar një propozim duke e shtyrë gjykatën t'i refuzojë ankesat e të gjithë mbrojtësve.

Ankesa e M.I.: sipas nenit 360 të KPP-së, gjykata detyrohet me veprat e përshkruara në aktakuzë ndërsa nuk detyrohet me propozimet e prokurorit lidhur me kualifikimin ligjor të

---

<sup>3</sup> Prokurori e orienton këtë paragraf, dhe brenda tij i referohet ankesës së M.R. Megjithatë, ky i pandehur është liruar nga të gjitha akuzat dhe nuk ka parashtruar ankesë. Prokurori patjetër duhet ta ketë menduar D.M.

veprës. Gjykata i ka vlerësuar të gjitha veprat e përshkruara në aktakuzë dhe ua ka atribuar atyre një kualifikim ligjor. Prandaj nuk ekziston shkelje e ligjit procedural. Burimi i provave të kundërshtuara të regjistrimit fotografik ose me video nuk e identifikon doemos personin i cili vërtet i ka bërë ato. Kjo provë është mbledhur nga policët e autorizuar të UNMIK-ut dhe KFOR-it në përputhshmëri me kodin e procedurës penale në fuqi në atë kohë. Gjatë gjykimit nuk ka pasur asnjë deklaram për kualitet të dobët ose regjistrim të manipuluar fotografik ose me video. Gjykata ka analizuar secilën fotografi dhe regjistrim. Në aktgjykimin e vet, gjykata ka dhënë arsyet pse i është përkushtuar peshës që u ka dhënë dëshmitë. Mospërputhshmëritë në provat e z. D. janë shpjeguar e është vërtetuar edhe besueshmëria. Ai madje ka përmendur edhe faktet në favor të të akuzuarit.

Ankesa e Z.Č.: Ankesa nuk i përmbush kushtet ligjore dhe duhet hedhur poshtë.

Ankesa e D.M.: Me aktakuzë i pandehuri është akuzuar me katër akuza e jo me dy sikurse ka pohuar. Sa i përket çështje së kualifikimit ligjor të veprave penale dhe parashtrësve lidhur me pranueshmërinë e provave fotografike dhe me video, prokurori i apelit i referohet përgjigjes së tij të mëparshme. Si rrethanë lehtësuese gjykata ka marrë parasysh moshën e të pandehurit dhe kohën që prej kryerjes së krimeve. Megjithatë këta faktor nuk peshojnë më shumë se rrethanat rënduese të lëndës.

#### **4. Ligji i zbatueshëm e procedurës**

Procedura është iniciuar para hyrjes në fuqi të *kodit të ri të procedurës penale të Kosovës* më 1 janar 2013. Inicimi i hetimit, ngritja e aktakuzës, konfirmimi i aktakuzës dhe fillimi i shqyrtimit gjyqësor janë zhvilluar derisa *kodi i mëparshëm procedural penal* ishte ende në fuqi. Pas kësaj kohe është kryer vetëm aktgjykimi. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur ta zbatojë *kodin e ri të procedurës penale të Kosovës* në të gjitha procedurat pas datës 1 janar 2013. Edhe palët i kanë parashtruar ankesat e tyre në përputhshmëri me dispozitat e kodit të ri.

Kolegji i apelit ka një mendim tjetër. Rregulla e përgjithshme e nenit 539 të KPPK-së *a contrariu senso* është se kodi i mëparshëm mbetet i zbatueshëm në procedurat penale të iniciuara para hyrjes në fuqi të kodit të ri. Përrjashtimet e parapara me nenet 540 dhe 541.1 të KPPK-së nuk duhet të merren parasysh sepse aktakuza tanimë ishte ngritur dhe konfirmuar më 1 janar 2013. Kolegji i apelit është në dijeni të vështirësisë që rrjedh nga interpretimi i nenit 541.2 të KPPK-së pasi që i njëjti thotë se kodi i ri është i aplikueshëm madje edhe në rastet në të cilat aktakuza është konfirmuar para asaj date. Por këto dispozita duhet të jenë subjekt i interpretimit të kombinuar dhe koherent pasi që është e dukshme se paragrafët 1 dhe 2 të kodit të referuar janë në mospajtim me njëri tjetrin. Rregulli i përgjithshëm në sekuencën e ligjeve është se ligji i ri prodhon vetëm efekt për të ardhmen dhe zbatimi retroaktiv është i

jashtëzakonshëm<sup>4</sup>. Po ashtu nuk ka shumë kuptim që procedurat për një fazë procedurale të caktuar mund të rregullohen me ligje të ndryshme, pasi që kjo mund të paraqes vështirësi dhe mosmarrëveshje të panevojshme mbi rregullat e zbatueshme, në veçanti, nëse sequenca ose forma e veprave është e ndryshme. Kolegji i apelit ka mendim të njëjtë me Gjykatën Supreme<sup>5</sup>, sipas të cilit në rast se shqyrtimi gjyqësor ka filluar tashmë para datës 1 janar 2013, mbetet i zbatueshëm kodi i mëparshëm procedural.

Përcaktimi i ligjit të zbatueshëm është çështje e kualifikimit ligjor që Gjykata e Apelit mund ta shqyrtojë dhe vendos *sipas detyrës zyrtare*. Fakti që gjykata e shkallës së parë nuk i kishte aplikuar në mënyrë korrekte rregullat procedurale nuk ka ndikim në vlefshmërinë e aktgjykimit. Pra, të gjitha veprimet procedurale të kryera nga gjykata dhe palët do të duhet të vlerësohen dhe vendosen në kuadër të ligjit të zbatueshëm e që është *kodi i procedurës penal*.

## 5. Pranueshmëria e ankesave

Të gjitha ankesat e mbrojtjes janë parashtruar në kohë dhe janë të pranueshme.

Kolegji i apelit, megjithatë, konsideron se ankesa e prokurorit ishte parashtruar me vonesë.

Një raport është siguruar nga kryetari i kolegjit të shkallës së parë, në pajtueshmëri me nenin 409(4) të KPP-së. Dokumentet gjenden në shkresat e lëndës dhe raporti përmban se:

- Aktgjykimi i është dorëzuar prokurorisë më 26 korrik 2013;
- Afati për ankesë është 15 ditë nga dita kur dorëzohet një kopje e aktgjykimit<sup>6</sup>; kjo periudhë ka kaluar më 12 gusht 2013;
- Ankesa e prokurorit është parashtruar më 13 gusht 2013;
- Zyrtari ligjor i kryetarit të kolegjit e ka ftuar prokurorin të paraqes arsyet për vonesë të ankesës;
- Prokurori i ka paraqitur parashtresë gjyqtarit për ta arsyetuar vonesën duke pohuar se përkthimi i ankesës në gjuhën serbe është kryer rreth orës 19.29, më 12 gusht 2013 dhe se, duke pasur parasysh kohën e pranimit të përkthimit në gjuhën serbe, ankesa ishte ushtruar vetëm ditën e nesërme për shkak se praktika administrative e shkrimores së Gjykatës Themelore është për të pranuar dokumentet nga prokuroria në të dy gjuhët, në gjuhën angleze edhe në atë serbe edhe nëse është në dispozicion versioni në gjuhën angleze dhe është në pritje përkthimi.

---

<sup>4</sup> Kolegji i apelit pajtohet se mund të zbatohet ligji i ri i procedurës penale nëse përcakton rregulla më të favorshme për ushtrimin e të drejtës së mbrojtjes por e njëjta duhet të vlerësohet në kuadër të së drejtës së caktuar procedurale e jo në kuadër të një zbatimi të përgjithshëm dhe të pakufizuar të ligjit të ri.

<sup>5</sup> Përrjashtimi në pjesën përfundimtare të paragrafit 1 të Mendimit nr. 56/2013, të datës 23 janar 2013, të Seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme. Mendimi juridik i Gjykatës Supreme i sjellë në kushte të përgjithshme nuk është detyrues për gjykatat por i njëjti mund të vlerësohet si element i vlefshëm i interpretimit ligjor.

<sup>6</sup> Neni 398(1) i KPP-së

- Ankesa e prokurorit tashmë i ishte dorëzuar të pandehurve për përgjigje dhe kryetarja e kolegjit nuk e ka hedhur atë poshtë në pajtueshmëri me nenin 407(2) të KPP-së<sup>7</sup>, e as nuk ka marrë vendim për arsyetimin e dhënë;

- Kryetarja e kolegjit në shkallën e parë, sa i përket njohurisë dhe informacioneve të cilat ajo i ka kërkuar, nuk e ka konfirmuar ekzistimin e një praktike të shkrimores sikurse është pohuar nga prokurori. Përkundrazi, informacionet e siguruara janë se shkrimorja e gjykatës do të pranonte dhe vuloste të gjitha parashtrirat e ushtruara dhe se një ankesë e parashtruar vetëm në gjuhën angleze nuk do të refuzohej;

- Prokurori nuk ka paraqitur përgjigje për kthim në *status quo ante* sipas neneve nga 96 deri në 98 të KPP-së.

Kur i është kërkuar arsyetimi i vonesës, prokurori ka pasur mundësinë e paraqitjes së kërkesës për kthim në gjendjen e mëparshme *status quo ante* në bazë të neneve 96 dhe 98 të KPP-së. Një gjë e tillë nuk është bërë dhe prokurori ka zgjedhur të parashtojë justifikimin me shkrim duke deklaruar se ankesa në fjalë ishte parashtruar me kohë për shkak të arsyeve të dhëna të cilat lidhen me vonesat gjatë përkthimit dhe me praktikën e shkrimores së gjykatës. Megjithatë, asnjë prej këtyre arsyeve nuk janë të pranueshme. Anglishtja është një prej gjuhëve zyrtare të procedurës dhe ankesat mund të parashtrohen në këtë gjuhë (neni 15 (1) dhe (4) i KPP-së). Prandaj, nëse ka ekzistuar një praktikë e tillë e shkrimores një gjë e tillë do të ishte e kundërligjshme për arsye se ka mundur të dorëzohet në gjuhën angleze dhe të përkthehet më vonë. Për më tepër – dhe kjo duhet të konsiderohet disi shqetësuese – praktika e pohuar e cila është dhënë për ta arsyetuar veprimin e vonuar të prokurorisë nuk është praktikë e konfirmuar<sup>8</sup>. Fakti se përkthimi në gjuhën serbe ka mundur të kryhet pas orarit të punës në ditën e fundit të afatit kohor nuk është justifikim relevant, pasi që çdo palë është e obliguar ta organizojë punën e vet me qëllim të përmbushjes së obligimeve procedurale.

Fakti se kryetari i trupit gjykues nuk e ka hedhur poshtë ankesën para se t'ua dërgojë të pandehurve për përgjigje nuk e pengon Gjykatën e Apelit që ta shqyrtojë çështjen. Neni 420 (1.1) i KPP-së lejon hedhjen poshtë të ankesës së paafatshme ndaj aktgjyqimit në fazën e apelit.

Për arsyet e përmendura më lart, ankesa e parashtruar nga prokurori hedhet poshtë.

## **6. Bazat e ankesave**

### **6.1 Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale**

#### Provat e papranueshme

<sup>7</sup> Pasi në procedurën e shkallës së parë është zbatuar kodi i ri i procedurës që nuk ka dispozitë të barasvlefshme, kryetari i kolegjit ka konsideruar se neni 407(2) nuk ka qenë i zbatueshëm.

<sup>8</sup> Gjykata e Apelit beson se duhet të ketë pasur patjetër një lloj keqkuptimi pasi nuk mund të pritët nga prokuroria të dështojë në sigurimin e informatave të vërteta dhe të besueshme me qëllim të justifikimit të vonesës nga ana e tyre.



Papranueshmëria e regjistrimeve me video dhe fotografi si prova është ngritur si arsye e ankesave të parashtruara në emër të të pandehurve M.I., Z.Č. dhe D.M. Në bazë të pohimeve të tyre, shkurtimisht, provat e tilla janë të ndaluara sepse origjina e tyre është e panjohur gjë e cila i bën të pabesueshme, sipas nenit 259.2 të KPPK-së. Provat e papranueshme janë të tilla kur sigurohen me shkelje të dispozitave procedurale dhe kur shprehimisht përcaktohen me ligj si të tilla. Ato prova nuk mund të përdoren si bazë për vendimin e gjykatës (neni 153 i KPP-së). Neni 403 (1) 8) i KPP-së përcakton që përdorimi i provave të papranueshme është shkelje esenciale e procedurës penale. Në qoftë se ndodh një shkelje e tillë, aktgjykimi duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim, sipas nenit 424 (1) të KPP-së (përveç në situatat të cilat nuk janë relevante tani).

Gjatë gjykimit palët e kanë kontestuar pranueshmërinë e videove dhe fotografive si prova, por trupi gjykues e ka refuzuar kundërshtimin në fjalë dhe i konstatuar të pranueshme këto prova. Pasi që palët kanë ngritur këtë çështje gjatë procedurës së parashtrimit të provave, ato kanë të drejtë tani të mbështesin ankesën e tyre lidhur me të njëjtën çështje (neni 154 (1) i KPP-së).

Në mënyrë të përmbledhur, arsyet e dhëna nga ankuesit që pretendojnë papranueshmërinë e provave janë si në vazhdim: nuk dihet se kush i ka bërë këto video dhe fotografi, prandaj ato janë thelbësisht të pambështetshme sipas dispozitës ligjore në fjalë; mbledhja e atyre provave nuk i ka respektuar procedurat e zbatueshme për sigurimin e masave teknike të vëzhgimit gjatë hetimeve të përcaktuara me nenin 257 të KPP-së.

Mbrojtësi i të pandehurit M.I i është referuar lëndës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) *Hysein dhe të tjerët kundër shtetit të Azerbajxhanit dhe Asadbeyly dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit*. Janë gjetur dy lëndë me emra të ngjashëm: *Huseyn dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit*<sup>9</sup> si dhe *Asadbeyli dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit*<sup>10</sup> por ato nuk lidhen me çështjen kontestuese. Është e natyrshme të pritët nga mbrojtja që të bëjë referime të drejta kur të citojë praktikën gjyqësore me qëllim të mbështetjes së argumenteve të tyre. Emrat nuk janë shkruar drejt dhe mungojnë citatet dhe datat e aktgjykimeve. Çka është më e rëndësishme, mungojnë të dhënat lidhur me gjetjet e GjEDNj-së (numrat e paragrafëve apo citimet) në këto lëndë të cilat do t'i mbështesnin parashtrësit e mbrojtjes përkitazi me këtë pikë. Nuk i takon Gjykatës së Apelit të shoshitë aktgjykime të tilla të gjata për të gjetur se cilat argumente të cilat mund të mbështesin parashtrësit e palëve. Përndryshe, kolegji nuk e ka të qartë se në çfarë mënyre këto lëndë mund t'iu ndihmojnë ankesave të parashtruara.

Lidhur me argumentet specifike ligjore për kontestimin e përdorimit të videove dhe fotografive si prova, kolegji i apelit vëren se asnjë dispozitë e ligjit të procedurës në fuqi<sup>11</sup> nuk i përshkruan shprehimisht si të papranueshme provat në fjalë. Neni 259.2 i KPPK-së nuk ka ndonjë nen të barasvlerëshëm në kodin e ri të procedurës – KPP. Parimi i mosmbështetjes së provave me prova

<sup>9</sup> 35485/05, 45553/05, 35680/05, 36085/05 i formës së prerë i datës 26 korrik 2011

<sup>10</sup> 3653/05, 14729/05, 20908/05, 26242/05, 36083/05, 16519/06 i formës së prerë i datës 11 dhjetor 2012.

<sup>11</sup> Siç është theksuar më herët, kodi i zbatueshëm është kodi i mëhershëm i procedurës penale.

të cilat kanë origjinë të panjohur ka për qëllim t'iu sigurojë palëve mundësinë për ta kontrolluar burimin e provave dhe duke bërë këtë të mund ta kontestojnë vlerën e këtyre provave. Në mungesë të një dispozite të tillë në ligjin procedural në fuqi, nuk mund të kontestohet vlefshmëria e këtyre provave, por besueshmëria e tyre është çështje të cilën duhet ta vlerësojë gjykata gjatë vërtetimit të gjendjes faktike. Në këtë rast, palët nuk e kanë vënë në pikëpyetje vërtetësinë e provave. Është e pakontestueshme se videot dhe fotografitë i tregojnë ngjarjet që kanë ndodhur në ditën dhe në vendin në fjalë. Prandaj, fakti që origjina e provave mund të mos dihet bëhet fakt i parëndësishëm për shkak se palët e kanë pranuar se pamjet e kapura në video dhe në foto janë autentike dhe lidhen me ngjarjet në fjalë. Për më tepër, kolegji i apelit është i mendimit se provat në fjalë në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen me origjinë të panjohur, edhe pse nuk është vërtetuar se kush janë personat të cilët i kanë bërë. Është e qartë se këto video dhe foto janë realizuar nga prapa vijës së sigurimit e cila po mundohej ta mbante nën kontroll turmën e përfshirë në trazira si dhe nga helikopteri në ajër. Kjo i mundëson gjykatës të konstatojë se këto video dhe foto janë bërë nga persona zyrtarë qoftë nga Policia e KB-së apo nga KFOR-i. Nuk ka qenë e pamundur të vërtetohet origjina e tyre prandaj edhe nuk mund të cilësohet si e panjohur, në kuptimin që nuk mund të vërtetohet. Sidoqoftë, kjo çështje nuk ka rëndësi pasi që palët e kanë pranuar se pamjet në fjalë lidhen me ato ngjarje.

Kolegji i apelit konstaton se janë të qarta rregullat për mbledhjen e dëshmimeve fotografike apo me video me masa të fshehta vëzhgimi, të përcaktuara me nenet 257 – 267 të KPP-së, përkatësisht nevoja e urdhrit gjyqësor, në thelb nuk do të vlente për fotografitë dhe videot e marra në hapësira publike para hetimeve penale. Nuk është e arsyeshme të interpretohet ligji në asi mënyre e cila do të jepte një rezultat të pamundshëm. Në vazhden e ngjarjeve të cilat po ndodhnin, ka qenë thjesht e pamundshme të përfundohet një aktvendim për fillim të hetimeve, një kërkesë për masa të vëzhgimit, apo një aktvendim të gjyqtarit paraprak me të cilin urdhërohen këto masa. Kjo nuk është e arsyeshme dhe madje është e diskutueshme nëse një gjë e tillë mund të konsiderohet argument serioz.

Trupi gjykues ka konstatuar se pamjet janë regjistruar në një hapësirë publike dhe, duke i pasur parasysh këto veprime të dyshuara kriminale, në bazë të nenit 201 të KPP-së organet policore kanë të drejtë të sigurojnë prova, të ndërmarrin hapat e nevojshëm për konstatimin e identitetit të kryerësve dhe të mbledhin informata rreth veprimeve të tyre. Kolegji i apelit pajtohet plotësisht me arsyetimin e trupit gjykues.

Përveç kësaj, kolegji i apelit gjen se e drejta themelore në privatësi dhe mbrojtje të pamjes së personit nuk shkelet nëse ai person është duke e kryer një krim në një vend publik, në mënyrë të vullnetshme para të gjithëve dhe në kontekstin në të cilin është e arsyeshme të pritët nga organet se do të bëjnë foto apo video. Duke vepruar në këtë mënyrë, duhet të kuptohet se kryerësi është duke hequr dorë nga e drejta e vet në privatësi.

E drejta në privatësi përfshihet në nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj). Konventa e pranon ndërhyrjen e organit publik në ushtrimin e kësaj të drejte në qoftë se është në përputhje me ligjin dhe nëse është e nevojshme në një shoqëri demokratike për interesa të sigurisë kombëtare, të sigurisë publike, të parandalimit të trazirave apo krimit ose për

mbrojtjen e të drejtave apo lirive të personave të tjerë. Në rastin *Friedl kundër shtetit austriak*<sup>12</sup> ((1995) 21 GJEDNj 88), parashtruesi i kërkesës kishte marrë pjesë në një demonstratë e cila kishte penguar qarkullimin në autostradë. Policia kishte bërë fotografi të pjesëmarrësve, duke përfshirë këtu edhe parashtruesin e kërkesës. Komisioni për të drejtat e njeriut të cilit i ishte referuar lënda në fjalë, duke e konstatuar se nuk kishte pasur ndërhyrje në “rrethin e brendshëm” të jetës private të parashtruesit dhe duke konstatuar se parashtruesi ka qenë aty në mënyrë të vullnetshme, ka gjetur se marrja dhe mbajtja ose ruajtja e fotografive në fjalë nuk e ka shkelur nenin 8.

Përfundimisht, argumenti se me politikën e YouTube ndalohet shkarkimi i videove të tyre është një argument krejt i parëndësishëm për këtë diskutim. Gjykata është duke e trajtuar pranueshmërinë dhe vlerën e videos si provë dhe kjo çështje nuk ndikohet me asnjë shkelje të mundshme të të drejtave të autorit apo të drejtave të barasvlershme.

Provat për këtë arsye janë të pranueshme. Trupi gjykues ka pasur lirinë e veprimit gjatë vlerësimit se çfarë peshe meritore duhet t’i jepet provave të tilla. Kolegji i apelit nuk gjen asnjë arsye të vlefshme për t’u mos pajtuar.

### Aktgjykimi ka tejkalluar akuzën

Mbrojtësi i të pandehurve M.I. dhe D.M. kanë pretenduar se aktgjykimi ka tejkalluar akuzën pasi që ata janë dënuar për veprat penale për të cilat nuk kanë qenë të ngarkuar me aktakuzë. Me këtë nuk pajtohet as prokurori as prokurori i apelit.

Kjo shkelje esenciale përcaktohet me nenin 403 (1) (10) të KPP-së.

Me qëllim të analizës së kësaj çështjeje është e domosdoshme të vërtetohet saktësisht me çka janë akuzuar të pandehurit, pasi që aktakuza së pari është ndryshuar në seancën për konfirmimin e aktakuzës dhe më vonë më datën 20 mars 2013 nga ana e prokurorit. Dyshimi lidhur me përmbajtjen e akuzave del nga fakti se prokurori ka bërë kërkesë për ndryshimin e aktakuzës në një mënyrë të dyshimtë. Mund të konsiderohet e paqartë nëse prokurori e ka ndryshuar aktakuzën, duke e anuluar atë të mëparshmen (gjë e cila siç duket pretendohet nga të pandehurit) apo e ka plotësuar atë (ashtu siç e ka konstatuar trupi gjykues apo ashtu siç e lexon prokurori i apelit). Duke e lexuar me vëmendje parashtruesin e prokurorit, edhe pse është e qartë se ka pasur mundësi dhe është dashur të jetë më e qartë, kolegji i apelit është i mendimit se ndryshimi i bërë i ka plotësuar akuzat fillestare por i ka lënë të paprekura ato akuzat të cilat nuk janë përmendur apo ndryshuar. Një konkluzion i tillë del nga fakti se prokurori nuk i ka përfshirë në një ndryshim të tillë një numër akuzash të cilat ishin konfirmuar nga gjyqtari për konfirmim të aktakuzës, por që në të njëjtën kohë nuk i kishte tërhequr<sup>13</sup>. Fakti se gjykimi ka

<sup>12</sup> Lënda është ndërprerë me një marrëveshje por mendimi i Komisionit për të drejtat e njeriut është aneks i vendimit të GjEDNj-së: [http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-57917#{"itemid":\["001-57917"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-57917#{)

<sup>13</sup> Për shembull në rastin e të pandehurit N.J. prokurori nuk e ka përmendur asnjë prej akuzave në kërkesën për ndryshim të aktakuzës.

vazhduar me adresimin e akuzave të lëna jashtë mjafton për t'i vënë në dijeni të pandehurit rreth faktit se akuzat nuk ishin tërhequr në mënyrë absolute. Prandaj, akuzat për të cilat trupi gjykues duhej të vendoste ishin ato të cilat janë konfirmuar nga gjyqtari konfirmues dhe të plotësuara në kërkesën për ndryshimin e aktakuzës.

M.I. në aktvendimin për konfirmimin e aktakuzës është akuzuar për këto vepra penale *Thirrje për rezistencë* (Neni 319 KPK), *Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (Neni 316.3 KPK), *Pjesëmarrje në grup që kryen veprë penale* (Neni 320.1 KPK) dhe *Rrezikim i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to* (Neni 142.3 KPK). Prokurori e ka plotësuar aktakuzën duke e akuzuar të pandehurin edhe për *Pjesëmarrje në grupin që pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (Neni 318.1 KPK). Ai është dënuar për veprën *Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (Neni 316.3 KPK), *Pjesëmarrje në grupin që pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (Neni 318.1 KPK), *Pjesëmarrje në grup që kryen veprë penale* (Neni 320.1 KPK) dhe *Rrezikim i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to* (Neni 142.2 KPK). Ai është liruar për *Pjesëmarrje në grupin që pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare*, për veprimet më datën 14 mars (Neni 318.1 KPK), *Thirrje për rezistencë*, për veprimet më datën 17 mars (Neni 319 KPK) dhe për veprën *Rrezikim i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to*, për veprimet më datën 17 mars (Neni 142.3 KPK).

D.M. në aktvendimin për konfirmim të aktakuzës<sup>14</sup> është akuzuar për veprat penale *Pjesëmarrje në grup që kryen veprë penale* (Neni 320.1 KPK) si dhe *Rrezikim i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to* (Neni 142.3 KPK). Prokurori e ka plotësuar aktakuzën duke e ngarkuar të pandehurin edhe për *Pjesëmarrje në grupin që pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (Neni 318.1 KPK). Ai është dënuar për veprën *Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (Neni 316.3 KPK), *Pjesëmarrje në grupin që pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (Neni 318.1 KPK), *Pjesëmarrje në grup që kryen veprë penale* (Neni 320.1 KPK) dhe (4) *Rrezikim i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to* (Neni 142.2 KPK). Ai është liruar për veprën *Pjesëmarrje në grupin që pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare*, për veprimet më datën 14 mars (Neni 318.1 KPK) si dhe *Rrezikim i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to*, për veprimet më datën 17 mars (Neni 142.3 KPK).

Nuk ka fije dyshimi se faktet relevante për plotësimin e kushteve për veprën penale duhet patjetër të përfshihen në aktakuzë (Neni 305 (1) (2) KPP). Pas konfirmimit nga gjyqtari konfirmues, gjendja faktike për të cilën akuzohen me aktakuzë do ta kufizojë objektin e shqyrtimit gjyqësor dhe faktet të cilat mund të merren parasysh për ta vërtetuar fajësinë e dikujt në aktgjykim. Aktakuza po ashtu mund të ndryshohet nga prokurori gjatë shqyrtimit gjyqësor, por në atë rast mbrojtjes i sigurohet e drejta për dhënien e mendimit të saj dhe për paraqitjen e provave (Neni 376 KPP). Dispozitivi është pjesë e aktgjykimit dhe përmban vendimin e

---

<sup>14</sup> Ai po ashtu është akuzuar edhe për *pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare* (Neni 316.3 KPK), por prokurori e ka tërhequr këtë akuzë më 20 mars 2013. Megjithatë, kjo tërheqje nuk ka ndikuar në akuzat faktike, pasi që prokurori vetëm ka propozuar një cilësim të ri i cili ka konsumuar veprën penale në fjalë.

ekzekutueshëm dhe faktet relevante që janë konstatuar të provuara (Nenet 391 (1) 1) dhe 396 (3), (4) KPP). Arsyetimi do t'i tregojë faktet të cilat janë provuar dhe nuk janë provuar si dhe provat e vlerësuara se arsyetojnë vendimin (Neni 396 (7) KPP). Aktgjykimi mund t'iu referohet vetëm fakteve të cilat i përmban akuza (Neni 386 (1) KPP). Në qoftë se ai e tejkalon gjendjen faktike lidhur me veprat e ngarkuara, d.m.th. nëse dispozitivi përmban fakte tjera nga faktet në aktakuzë, atëherë kjo paraqet shkelje esenciale të procedurës (Neni 403 (1) 10) KPP).

Kolegji i apelit vëren se gjendja faktike e aktakuzës nuk është ndryshuar. Faktet për të cilat janë akuzuar të pandehurit janë po ato të njëjtat me të cilat është marrë trupi gjykues në aktgjykim, duke i vërtetuar si të provuara apo të paprovuara. Kundërshtimi i ankuesve i referohet cilësimit juridik të këtyre fakteve i cili është ndryshuar disa herë gjatë procedurës. I pandehuri D.M. është dënuar për veprën penale të përcaktuar nga neni 316.3 i KPK-së, e cila më herët ishte tërhequr nga prokurori, por – dhe kjo është esenciale për t'u theksuar – duke u bazuar saktësisht dhe vetëm në faktet e njëjta. Nga ana tjetër, edhe ai edhe i pandehuri M.I. janë liruar për veprat penale të përcaktuara me nenet 318.1 dhe 142 të KPK-së, por, përsëri, jo në kundërshtim por në vend të kësaj si rezultat i faktit se trupi gjykues nuk i ka vërtetuar si të provuara disa prej fakteve të cilat u janë ngarkuar të pandehurve. Prandaj, çështja së cilës duhet t'i japim tash përgjigje është nëse trupi gjykues, edhe pse pa shtuar fakte të reja, ka pasur të drejtë ta ndryshojë cilësimin juridik të fakteve në aktgjykimin e formës së prerë pa i paralajmëruar palët.

Gjykata nuk iu detyrohet propozimeve të prokurorit lidhur me cilësimin juridik të veprës (Neni 386 (2) KPP). Kjo do të thotë se përderisa gjykata nuk i tejkalon faktet e përfshira në akuzë, ajo është e lirë t'i cilësojë ato ndryshe dhe të dënojë për vepra penale të cilat nuk janë propozuar nga prokuroria. Por çështja është nëse gjykata mund ta bëjë një gjë të tillë pa i dhënë mbrojtjes mundësinë për ta parashtruar mendimin lidhur me këtë, pra nëse ky ndryshim është në dëm të mbrojtjes apo jo? Kjo çështje lidhet drejtpërdrejt me mbrojtjen e dhënë për të drejtën në mbrojtje efektive si një prej aspekteve të së drejtës në gjykim të drejtë.

E drejta në gjykim të drejtë si një prej të drejtave themelore mbrohet me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Mbrojtja kushtetuese që i jepet kësaj të drejte duhet të interpretohet në të njëjtën shkallë sikur neni 6 i Konventës evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, siç përkufizohet me jurisprudencën e KEDNj-së (Nenet 22 (2) dhe 53 të Kushtetutës). Prandaj, është me rëndësi të shihet sa larg shkon jurisprudenca e KEDNj-së në nenin 6.3 (a) të Konventës, lidhur me të drejtën për t'u informuar shpejt dhe në hollësi lidhur me natyrën dhe shkakun e akuzave.

Në lëndën *Salvador Torres kundër Spanjës* është pohuar se fakti që i pandehuri ishte dënuar për një vepër penale me rrethana rënduese për të cilat ai kurrë shprehimisht nuk ishte akuzuar përbënte shkelje të nenit 6.3 (a). Gjyqtari hetues në këtë lëndë kishte gjetur se faktet e vërtetuara nga ana e tij kanë vënë në pah veprën penale të “përvetësimit të fondeve publike”. Gjykata e shkallë së parë kishte gjetur se paragrafi i përvetësimit të fondeve publike nuk ishte i zbatueshëm për shkak se ai nuk ishte shërbyes civil siç kërkohet dhe se paratë e përvetësuara nuk ishin fonde publike prandaj ai u shpall fajtor për përvetësim të thjeshtë dhe u dënua me 18 muaj burgim. Prokuroria kishte apeluar vendimin ndërsa i akuzuari jo. Gjykata Supreme po

ashtu kishte gjetur se nuk mund të zbatohet “përvetësimi i fondeve publike”. Ata megjithatë e kishin shpallur fajtor për një formë të rënduar të përvetësimit të thjeshtë për shkak se kishte përfituar nga natyra publike e pozitës së tij ku kryente detyra që i besoheshin prandaj ishte dënuar me pesë vjet burgim. Gjykata kishte gjetur se natyra publike e pozitës së parashtruesit ishte një element esencial përbërës i akuzës origjinale të përvetësimit të fondeve publike dhe rrjedhimisht i njohur për parashtruesin që nga fillimi i procedurave. Rrjedhimisht ishte konsideruar se ai ka qenë në dijeni rreth mundësisë se gjykatat do të konstatojnë se ky element themelor faktik do të mund të përbënte – në kontekstin e përvetësimit më të lehtë – një rrethanë të rënduar gjatë përcaktimit të dënimit. Nuk ishte gjetur asnjë shkelje e të drejtave të parashtruesit sipas nenit 6. Në këtë lëndë, gjykata kishte deklaruar se ndryshimi i cilësimit juridik duhet të ishte i pritshëm nga mbrojtja pasi që në akuzë sugjerohej një ndryshim i tillë.

Në lëndën *T. kundër Austrisë* parashtruesi kishte bërë një kërkesë për ndihmë juridike në një lëndë që ishte në zhvillim e sipër. Ai kishte deklarimin e pasurisë, sipas së cilës nuk kishte të ardhura, ndonjë pronë apo pasuri të tjera. Formulari standard për një deklaram të tillë e përmbante një paralajmërim që në rast se ndihma juridike sigurohej përmes deklaratave të rrejshme apo jo të plota mund të shqiptohet gjopa për keqpërdorim të procesit. Gjykata, pa e dëgjuar fare, e kishte hedhur poshtë kërkesën e parashtruesit dhe ia kishte shqiptuar gjobën për keqpërdorim të procesit. Gjykata e apelit kishte konstatuar se parashtruesi e parashtruesit të kërkesës se i kishte disa kursime me të cilat mund ta paguante qiranë përbënte fakt të ri i cili ishte provë e papranueshme në procedurën e apelit. Gjykata me të drejtë kishte konstatuar se ai kishte bërë deklaram jo të plotë ose të rrejshëm dhe se gjopa ishte shqiptuar me të drejtë. GjEDNj-ja kishte konstatuar se parashtruesi kishte marrë vesh për akuzat e drejtuara kundër tij vetëm pasi kishte pranuar vendimin e gjykatës. Edhe pse ai kishte të drejtën e ankesës, ankesa e tillë nuk kishte mundësinë e korrigjimit të lëshimeve të bëra gjatë procedurës së shkallës së parë për arsye se gjykata e apelit kishte konfirmuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë pa e mbajtur seancën dëgjimore prandaj parashtruesit e bëra nga parashtruesi gjatë mbrojtjes së tij ishin të papranueshme në shkallën e apelit. Në këtë rast gjykata kishte konstatuar shkeljen e nenit 6.3 (a). Me këtë lëndë vendoset një situatë dukshëm më ndryshe ngase ka të bëjë me njohjen paraprake të gjendjes faktike të vlerësuar dhe të vendosur nga gjykata, dhe jo vetëm një cilësim juridik tjetër.

Në lëndën *Dallos kundër Hungarisë*, parashtruesi i kërkesës ishte ndjekur penalisht dhe ishte dënuar në shkallë të parë për përvetësim. Gjykata e apelit e kishte ri-cilësuar veprën si mashtrim; diçka për të cilën gjykata kurrë nuk ia kishte bërë të ditur se është një prej mundësive. GjEDNj-ja kishte përkujtuar se vlerësimi nëse procedurat kanë qenë të drejta duhet të bëhet duke e vlerësuar procedurën si tërësi. Dispozitat e nenit 6.3 (a) tregojnë nevojën për vëmendje të posaçme e cila duhet t’iu kushtohet njoftimit të të pandehurit me akuzën. Detajet e veprës kanë një rol kyç në procedurën penale, që nga momenti i dërgimit të tyre kur i dyshuari njoftohet me shkrim lidhur me bazën faktike dhe ligjore të akuzave kundër tij. Kjo dispozitë e Konventës ia garanton të pandehurit të drejtën për t’u informuar jo vetëm për “shkakun” e akuzave, do të thotë veprimet gjoja të kryera prej tij mbi të cilat mbështeten akuzat, por edhe veçoritë karakteristike të cilat u janë dhënë këtyre veprimeve. Këto informata duhet të jenë të

detajuara. GjEDNj-ja kishte konstatuar se parashtruesi vërtet nuk ishte në dijeni se ka mundur të përballet me ri-cilësimin e veprës së tij penale si mashtrim. Kjo rrethanë me siguri ia ka dëmtuar gjasat për t'u mbrojtur lidhur me akuzat për të cilat në fund ishte dënuar. Megjithatë, në këtë aspekt, GjEDNj-ja iu ka atribuuar rëndësi vendimtare procedurave në vijim para Gjykatës Supreme. Konstatohet se Gjykata Supreme e ka shqyrtuar në tërësi lëndën e parashtruesit, qoftë nga pikëpamja procedurale qoftë nga ajo ligjore materiale. Përveç studimit të shkresave të lëndës të gjykatave më të ulëta dhe të parashtresave të parashtruesit dhe të prokurorisë, kolegji shqyrtues ka dëgjuar në seancë publike edhe fjalët verbale nga mbrojtësi i parashtruesit dhe nga zyra e Kryeprokurorit të shtetit. Për më tepër, vetë Gjykata Supreme ka mundur ta zëvendësonte dënimin e parashtruesit me vendim të lirim të tij. Me këtë GjEDNj-ja kishte konstatuar se parashtruesi kishte pasur mundësinë e rritjes së mbrojtjes së tij para Gjykatës Supreme lidhur me akuzën e riformuluar. Duke e bërë vlerësimin e procedurës në tërësi – dhe duke pasur parasysh natyrën e shqyrtimit të kësaj lënde para Gjykatës Supreme – GjEDNj-ja ka qenë e bindur se të gjitha defektet e procedurës para gjykatës rajonale ishin korrigjuar në Gjykatën Supreme.

Në lëndën *Sipavičius kundër Letonisë*, parashtruesi ishte akuzuar në aktakuzë për dobi pasurore përmes mashtrimit dhe keqpërdorimit të detyrës. Ai ishte liruar nga akuzat në fjalë, por Gjykata Regjionale kishte gjetur se ai e kishte kryer detyrën e vet si polic në mënyrë të keqe për shkak të neglizhencës. Ky dështim i tij arrinte shkallën e shkeljes së një dispozite të caktuar të Aktit mbi policinë dhe gjyqtari e kishte shpallur fajtor për veprën penale neglizhencë ndaj detyrës zyrtare. Ai nuk ishte njoftuar lidhur me mundësinë e ri-cilësimit të veprës. GjEDNj-ja kishte përkujtuar dhe përsëritur gjetjet në lëndën *Dallos kundër Hungarisë*. Ajo kishte konstatuar se nuk kontestohet fakti se deri në shpalljen fajtor të tij parashtruesi nuk ishte njoftuar se Gjykata Regjionale kishte mundësi ta ri-cilësonte veprën si neglizhencë ndaj detyrës zyrtare. Një rrethanë e tillë sigurisht se ia kishte dobësuar mundësinë për t'u mbrojtur nga akuza në fjalë. Megjithatë, GjEDNj-ja kishte përsëritur se respektimi i nenit 6 duhej patjetër të vërtetohej në dritën e procedurës si tërësi, duke përfshirë këtu edhe procedurën e apelit. Në këtë lëndë, parashtruesi ka pasur të drejtën e kontestimit të dënimin të vet lidhur me të gjitha aspektet relevante ligjore dhe faktike pranë Gjykatës së Apelit, e cila i kishte dëgjuar palët në një dëgjim verbal ankimor dhe i kishte shqyrtuar ankesat e parashtruesit lidhur me ri-cilësimin e akuzës nga pikëpamja procedurale dhe ajo materiale. Nuk ishte pohuar se gjykata e apelit nuk kishte kompetencë për ta prishur vendimin mbi dënimin dhe për ta liruar parashtruesin apo se në shkallën e apelit parashtruesi nuk kishte mundësi të mbrohej nga këto akuza të riformuluara. Fakti se deklaratat e parashtruesit kundër ri-cilësimit kanë qenë të pasuksesshme nuk tregon se rishikimi i procedurave ka dështuar në korrigjimin e të metave të procedurës në shkallën e parë. Gjykata më tej ka deklaruar se kjo lëndë duhet domosdo të dallohet nga lënda *T. kundër Austrisë* sepse në atë rast ankesat e parashtruesit kundër ri-cilësimit ishin refuzuar si fakte të reja përbërëse të cilat ishin të papranueshme në apel si dhe pa e mbajtur seancën dëgjimore të apelit.

Në vazhden e vendimeve të përmendura më sipër, GjEDNj-ja ka qenë shumë e qartë duke theksuar se gjatë vlerësimit të efektivitetit të së drejtës në mbrojtje, duhet patjetër të merret

parasysh e tërë procedura. Në qoftë se i pandehuri e ka të drejtën e ankesës me të cilën ai ose ajo mund ta kundërshtojë atë që më parë ka qenë e panjohur për të ndërsa gjykata e apelit e ka mundësinë për ta rishikuar lëndën dhe për ta ndryshuar atë nëse e gjen se shkalla e parë ka gabuar në vendimin e saj, atëherë neni 6 nuk është shkelur.

Në bazë të kësaj jurisprudence, kolegji i apelit nuk mund ta konsiderojë se të drejtat e të pandehurve janë shkelur. Ata e kanë pasur të drejtën e ankesës ndërsa Gjykata e Apelit, pas mbajtjes së seancës në të cilën kanë mundur të prezantohen argumentet e tyre, ka të drejtë ta rishikojë lëndën si nga ana procedurale edhe nga ajo e ligjit material si dhe i ka të gjitha mundësitë ligjore për ndryshimin apo madje edhe prishjen e aktgjykimit. Për këtë arsye, nuk ka pasur shkelje të nenit 6 të Konventës dhe nuk ka arsye për anulimin e aktgjykimit për shkak të tejkalimit të mundshëm të aktakuzës e cila mund të korrigjohet po qe se është e nevojshme.

### Dispozitivi i pakuptueshëm apo i paqëndrueshëm

I pandehuri M.I. ka pretenduar se dispozitivi nuk është i qartë për shkak se ai ishte akuzuar me pesë (5) vepra ndërsa është gjykuar për shtatë (7) sosh.

Kjo shkelje esenciale përcaktohet me nenin 403 (1) 12) të KPP-së dhe ka të bëjë me shkeljen e mëhershme esenciale të pohuar e cila tashmë është adresuar nga kolegji i apelit.

Siç është thënë më parë, i pandehuri është akuzuar për veprat penale *Pjesëmarrje në grupin që pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, Thirrje për rezistencë, dhe Rrezikim i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to*, të përcaktuara me nenet 318.1, 319 dhe 142.3 të KPK-së, duke iu referuar veprimeve për të cilat ishte akuzuar të cilat pohohet se kanë ndodhur më 14 dhe 17 mars 2008. Prokurori i ka cilësuar veprimet të cilat kanë ndodhur në dy raste të ndryshme si një vepër të vetme penale dhe kjo ishte mënyra në të cilën ishte ngritur aktakuza. Trupi gjykues ka pasur një qasje ndryshe lidhur me cilësimin juridik dhe ka konsideruar se veprimet e kryera në ditë të ndryshme përputhen me veprat e ndryshme penale. Si pasojë e kësaj, meqenëse disa prej fakteve janë vërtetuar si të provuara dhe disa jo, i pandehuri është dënuar për veprat penale për të cilat janë provuar faktet ndërsa është liruar për ato vepra për të cilat nuk janë provuar.

Dispozitivi nuk është i pakuptueshëm apo kundërthënës. Mënyra në të cilën trupi gjykues ka marrë vendimin përputhet me arsyetimin e aktgjykimit. Nuk ka kundërthënie. Përkundrazi, po qe se trupi gjykues ka qenë i mendimit se veprimet e kryera në ditë të ndryshme nënkuptojnë dy vepra penale të kryera dhe disa të provuara e disa jo, pasoja logjike ka qenë ajo tek e cila është ardhur: lirim për veprimet e paprovuara dhe dënim për veprimet e provuara.

Kolegji i apelit konsideron se asnjë prej shkeljeve esenciale të pohuara nga ankuesit nuk janë bërë në shkallën e parë.



Përveç kësaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të të gjitha dokumenteve përkatëse, kolegji i apelit është gjithashtu i mendimit se nuk ka asnjë shkelje tjetër procedurale e cila do të mund të shqyrtohej sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 415 (1) të KPP-së.

## 6.2 Vërtetimi i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike<sup>15</sup>

Të gjithë ankuesit e kanë kontestuar vërtetimin e gjendjes faktike nga ana e trupit gjykues.

I pandehuri M.I. ka theksuar se videot dhe fotografitë nuk mund ta vërtetojnë praninë e tij në vendin e ngjarjes; dëshmia e dëshmitarit D. nuk është as e besueshme as e paanshme, pasi që një ditë kishte deklaruar se nuk e kishte parë të pandehurin atje ndërsa ditën tjetër e kishte thënë të kundërtën duke dhënë plot detaje, duke gënjyer se disa prej këtyre detajeve kanë mundur të shiheshin nga vendi prej nga po i shikonte ngjarjet ndërsa kur gjykata ka vizituar këtë vend është treguar se kjo është e pamundshme, dhe për çudi ai e ngatërronte zërin që lëshon një granatë dore me zërin e një predhë mortajash.

I pandehuri Z.Č. ka deklaruar me vendosmëri se gjendja faktike është vërtetuar gabimisht.

I pandehuri D.M. ka deklaruar se gjykata në mënyrë tërësisht të gabueshme i ka vërtetuar faktet për shkak se nuk e ka përmendur se vdekja e policit ka ndodhur për shkak të mungesës së ndihmës mjekësore dhe jo drejtpërdrejt nga plagët e shkaktuara prej shpërthimit të granatës dhe se është mbështetur vetëm në fotografitë dhe xhirimet e bëra pa e konstatuar se kush i kishte filmuar këto materiale.

Kolegji i apelit përkujton se rishikimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë lidhur me vërtetimin e fakteve lidhet me pohimet e bëra nga ankuesit. Ata, siç përkufizohet me ligj, duhet të ofrojnë “shpjegimin e ankesës” (neni 401 (10.3) i KPP-së). Motivi i ankesës për kundërshtimin e fakteve të vërtetuara duhet patjetër të jetë preciz dhe të shpjegojë qartë cilat prova do të tregojnë se një fakt i caktuar është dashur të konsiderohet i provuar apo i paprovuar dhe arsyeja pse. Ligji nuk iu jep palëve të drejtën në aktgjykimin e dytë por vetëm mundësinë e rishikimit të aktgjykimit, që është diçka tjetër. Nuk është e pritshme nga Gjykata e Apelit ta përsërisë shqyrtimin e të gjitha provave sikur të mos ekzistonte fare një aktgjykim i mëhershëm.

Ashtu siç është vërtetuar edhe më parë nga Gjykata e Apelit<sup>16</sup>, kur neni 405 i KPP-së i përkufizon shprehjet “vërtetim i gabueshëm i gjendjes faktike” dhe “vërtetim jo i plotë gjendjes faktike”, ai iu referohet gabimeve dhe lëshimeve që lidhen me “faktet materiale” të cilat janë të rëndësishme vendimtare për aktgjykimin e marrë<sup>17</sup>. Gjykata e Apelit e anulon aktgjykimin vetëm

<sup>15</sup> Në bazë të renditjes së çështjeve të vërtetuara në KPP, shkelja e ligjit penale e rregulluar me nenin 404 është përpara vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike e cila rregullohet me nenin 405. Kolegji i apelit zgjedh mënyrën e adresimit të këtyre çështjeve sipas renditjes logjike, pasi që zbatimi i ligjit duhet të vlerësohet pas vërtetimit të fakteve.

<sup>16</sup> PAKR 1121/12, aktgjykim i datës 25/09/2012.

<sup>17</sup> Aktgjykim i përmendur i referohet autorit B. Petric: komentimet e neneve të Ligjit jugosllav të procedurës penale, botimi i dytë i vitit 1986, neni 366, par. 3.

nëse gjykata e shkallës së parë ka bërë ndonjë gabim themelor gjatë vlerësimit të provave dhe gjatë vërtetimit të fakteve<sup>18</sup>.

Si parim i përgjithshëm vlerësimi i provave duhet të mbështetet në shqyrtimin e drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm të dëshmime verbale dhe deklaratave të kolegjit të gjyqtarëve. Të lexuarit nga procesverbali i provave të shqyrtuara në gjykim, sado besnik dhe i saktë që mund të jetë, është gjithmonë instrument më pak i besueshëm për vlerësimin e provave. Bile edhe shqyrtimi i dokumenteve dhe i provave të tjera materiale në përgjithësi bëhet në mënyrë më të saktë gjatë gjykimit sepse shpesh ato prova duhet të bashkohen me elemente të tjera dhe varen nga shpjegime verbale të dëshmitarëve apo palëve. Për këtë arsye, siç është vërtetuar nga kjo gjykatë edhe në lëndët e tjera<sup>19</sup>, *“Është parim i përgjithshëm në procedurat e apelit që Gjykata e Apelit duhet patjetër të ketë një lloj respekti për gjetjet faktike të trupit gjykues sepse ky i fundit ka qenë në pozitë më të mirë për t’i vlerësuar provat në fjalë”*. Gjykata Supreme e Kosovës është e mendimit se duhet patjetër *“ta respektojë vlerësimin e trupit gjykues lidhur me besueshmërinë e dëshmitarëve të gjykimit të cilët janë paraqitur personalisht para tyre dhe i kanë dhënë dëshmitë e tyre personalisht para tyre. Nuk i takon Gjykatës Supreme të Kosovës ta anashkalojë vlerësimin nga trupi gjykues të besueshmërisë së atyre dëshmitarëve nëse nuk ekziston një bazë e fortë për të bërë një gjë të tillë.”* Standardi të cilin e ka zbatuar Gjykata Supreme ka qenë *“mos t’i prekë gjetjet e gjykatës e cila e ka gjykuar lëndën vetëm nëse provat në të cilat është mbështetur gjykata nuk janë të pranueshme nga çfarëdo gjykate e arsyeshme faktike ose nëse vlerësimi i saj ka qenë tërësisht i gabueshëm”*.<sup>20</sup>

Kolegji i apelit ka shqyrtuar me kujdes të gjitha provat e shqyrtuara në gjykatën e shkallës së parë dhe vlerësimin e bërë nga trupi gjykues në aktgjykim. Aktgjykimi i apeluar, sipas mendimit të kolegjit të apelit, nuk përmban asnjë gabim të madh në vlerësimin e provave dhe në vërtetimin e fakteve. Ankuesit nuk kanë treguar se gjykata e shkallës së parë ka gabuar apo nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike. Krejt çfarë kanë vepruar ata për të nxjerrë konkluzione të cilat janë të papranueshme ka qenë ndriçimi i disa kundërthënieve apo mospërputhjeve të provave të nxjerra nga konteksti i përgjithshëm, duke i injoruar provat e tjera të cilat përputhen me to madje edhe rregullat e interpretimit të bazuara në logjikën e shëndoshë. Ata duan ta bindin Gjykatën e Apelit se nuk kanë qenë të pranishëm në vendin e ngjarjes duke i kryer veprimet e përshkruara në aktgjykim edhe pse shihen qartë në video dhe në fotografi në atë mënyrë të cilën trupi gjykues e ka shpjeguar hollësisht dhe në mënyrë bindëse.

Nga ana tjetër, autopsia e policit të vrarë është e pakontestueshme përkitazi me vërtetimin e shkakut të vdekjes, pasi që në mënyrë të plotë ajo e vërteton se vdekja ka ardhur si rezultat i plagëve të shkaktuara nga shpërthimi i granatës.

---

<sup>18</sup> PaKr 1122/12, aktgjykimi i datës 25.04.2013.

<sup>19</sup> PAKR 1121/12, aktgjykimi i datës 25/09/2012.

<sup>20</sup> Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 84/2009, 3 dhjetor 2009, par. 35; Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 2/2012, 24 shtator 2012, par. 30.

Në fund, kolegji i apelit nuk e sheh asnjë arsye për të hedhur dyshim në paanësinë dhe besueshmërinë e dëshmitarit R.D. I pandehuri M.I. është përpjekur t'i hulumtojë disa mospërputhje dhe kundërshti duke i nxjerrë ato nga konteksti i tërësishëm i provave. Kolegji i apelit është në dijeni rreth fakteve se dëshmitarit ka mundësi t'i mos kujtohen saktësisht të gjitha detajet e deklaratave të dhëna vite më parë. Ai kishte deklaruar se e njihte dhe e kishte parë të pandehurin në vendin e ngjarjes. Por, edhe pse nuk ishte krejt i qartë lidhur me këtë, është fakt se trupi gjykues e ka vërtetuar praninë e të pandehurve në vendin e ngjarjes dhe veprimet e tija nuk mbështeten vetëm në dëshminë e dëshmitarit por gjithashtu edhe në video dhe fotografi. Prandaj, kundërthënia lidhur me provat e D. bëhet provë e parëndësishme për të kontestuar vërtetësinë e dëshmisë së tij pasi që është vërtetuar në mënyrë të bollshme me prova të tjera të pakontestueshme.

Si përfundim, provat e dëshmitarëve, të dhëna gjatë fazës hetimore dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, janë shqyrtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse nga gjykata e shkallës së parë. Vlerësim i njëjtë i kujdesshëm u është bërë edhe provave të bollshme dokumentuese dhe të mjekësisë ligjore. Aktgjykimi sqaron në hollësi domethënien e këtyre provave dhe të kundërshtive në mes tyre në një mënyrë aq bindëse sa që e shtyn kolegjin e apelit të pranojnë se faktet e vërtetuara në aktgjykim si të provuara janë shpjegimi i vetëm i arsyeshëm, logjik dhe i mundshëm i provave në fjalë. Për këtë arsye, nuk qëndron se aktgjykimi përmban vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

### 6.3 Shkelja e ligjit penal

Ankesa në emër të të pandehurit D.M. është thirrur shprehimisht në shkelje të ligjit penal si një prej arsyeve për ta kundërshtuar aktgjykimin në fjalë. Duke e lexuar me kujdes ankesën e tij, vijmë tek përfundimi se në mënyrë specifike nuk është pohuar asnjë shkelje e cila përputhet me arsyet e përcaktuara me nenin 404 të KPP-së.

Megjithatë, ekziston një çështje me rëndësi të cilën kolegji i apelit e sheh të nevojshme ta adresojë lidhur me cilësimin juridik të fakteve dhe si rrjedhojë me veprat penale për të cilat janë dënuar të pandehurit. Neni 426 (1) i KPP-së i lejon Gjykatës së Apelit *ex officio* zbatimin e drejtë të ligjit për gjendje faktike në fjalë dhe ndryshimin e aktgjyqimit nëse një gjë e tillë është e nevojshme dhe e mundshme.

Trupi gjykues i ka shpallur fajtorë dhe i ka dënuar të tre të pandehurit për veprat penale *Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (Neni 316.3 i KPK-së), *Pjesëmarrje në grup për të penguar personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (Neni 318.1 i KPK-së), *Pjesëmarrje në grup që kryen veprë penale* (Neni 320.1 i KPK-së) si dhe *Rrezikim i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to* (Neni 142.2 i KPK-së). Duke e bërë të ditur se të pandehurit janë “dënuar për disa krime të cilat dalin nga veprimet e njëjta” trupi gjykues ka konstatuar, lidhur me bashkimin e krimeve, se veprimet mund të konsiderohen si një incident i vetëm në sjelljen e secilit të pandehur sepse ato janë bazuar në një vendim të vetëm, kanë

ndodhur pa ndërprerje dhe në rrethana dhe kohë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën. Duke e diskutuar teorinë e bashkimit ideal, kolegji ka gjetur se asnjë prej veprave penale të përcaktuara me nenet 142, 316, 318 dhe 320 të KPK-së nuk mund të konsiderohet si *lex specialis* për t'i konsumuar veprat e tjera, sepse secila përmban elemente specifike të cilat mungojnë në veprat e tjera, ndërsa interesat e mbrojtura juridike nuk përkrijnë me plotësisht me njëra tjetrën. Trupi gjykues po ashtu nuk ka konstatuar asnjë lidhje subsidiare ndërmjet dispozitave ligjore pasi që asnjë prej tyre nuk përcaktohet si alternativë ndaj të tjerave.

Pa paragjykuar identifikimin e gjykatës së shkallës së parë si gjykatë e cila ka kërkuar mbështetjen e vendimit të saj në teorinë e bashkimit të krimeve, kolegji i apelit nuk pajtohet me një konkluzion të tillë. Ky nuk është vendi as momenti për ta analizuar në detaje teorinë e bashkimit. Do të ishte e papërshtatshme – e mbase edhe e pamundshme – të mbulohen të gjitha aspektet dhe të zgjidhen të gjitha vështirësitë të cilat kjo çështje i ngre në mënyrë sintetike. Qëllimi i një vendimi gjyqësor nuk është shpallja e një doktrine juridike por zgjidhja e një lënde në përputhje me ligjin. Përkundër kësaj, do të ishte e dobishme të përkufizohen konceptet e caktuara para se të zbatohen në raste.

Gjatë vendosjes së shumë dënimeve për të njëjtin veprim, shpesh gjykatat zbatojnë të ashtuquajturin “test të Blockburger-it”<sup>21</sup>. Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara ka qenë e mendimit se dënimi për dy vepra penale të përcaktuara me ligj të cilat dalin nga e njëjta vepër penale apo transaksion nuk e shkel klauzolën e “rrezikut të dyfishtë” në qoftë se secila dispozitë kërkon që kjo të provohet me fakt plotësuar përderisa tjetra nuk kërkon një gjë të tillë. Kjo metodë kryesisht është sajuar për t'i ikur shkeljes së parimit *ne bis in idem*, d.m.th. që i njëjti fakt nuk mund të prodhojë dy sanksione penale.

Në sistemet e ligjit civil – siç është Kosova – gjykatat synojnë ta zgjidhin problemin e njëjtë duke i zbatuar rregullat e teorisë së bashkimit.

Bashkimi real konsiston në kryerjen nga i njëjti person të shumë veprave penale përmes veprimeve të veçanta<sup>22</sup>. Ky është një rast i bashkimit të krimeve i cili do të rezultojë me shumë dënime për të gjitha krimet të cilat praktikisht janë kryer. Bashkimi real, nga ana tjetër, konsiston në kryerjen e një veprimi të vetëm i cili duket se i plotëson kushtet ligjore të disa dispozitave ligjore (bashkimi ideal heterogjen) ose të dispozitës së njëjtë ligjore disa herë (bashkimi ideal homogjen)<sup>23</sup> por lidhur me të cilin mund të zbatohet vetëm njëri prej tyre. Thënë më drejt, kjo mund të shihet si bashkim i cilësimeve juridike në vend të bashkimit të krimeve, pasi që ka të bëjë me një veprim të vetëm i cili e mbulon përmbajtjen e normave të disa teksteve ligjore. Në raste të tilla, në bazë të rrethanave dhe pasojave të veprimit si të dhe vlerave të mbrojtura me secilën normë të shkelur, identifikimi i normës apo i normave të

<sup>21</sup> Blockburger kundër Shteteve të Bashkuara, 1932.

<sup>22</sup> Për shembull, një person e plaçkit, e dhunon dhe e vret të njëjtën viktimë apo i plaçkit, i dhunon dhe i vret viktimat e ndryshme.

<sup>23</sup> Për shembull, një person gjuan një granatë e cila vret një numër viktimash (homogjene) apo e gjuan një granatë e cila vret viktima dhe dëmton pasuri (heterogjene).

zbatueshme do të përcaktohet nga lloji i raportit ekzistues ndërmjet tyre: specialiteti, subsidiariteti, alternativa apo konsumimi. Në qoftë se në ndonjërin prej këtyre katër llojeve të raporteve gjenden norma kundërtënjëse të zbatueshme për të njëjtin veprim, atëherë kemi të bëjmë me bashkim ideal dhe në atë rast duhet të zbatohet një dënim i vetëm.

Dy norma janë në raport specialiteti kur njëra dispozitë (specialja) i përmban të gjitha elementet e dispozitës tjetër (dispozitës së përgjithshme) plus edhe një element shtesë. Në rastin e zbatimit të parimit *lex specialis derogat lex generalis* i pandehuri do të dënohet vetëm për veprën penale të përcaktuar me dispozitën e cila “ia kap” veprimin në mënyrë më të plotë. Për shembull: deklarata e rrejshme e dëshmitarit bashkëpunues nga neni 393 i KPRK-së është speciale në raport me deklaratën e rrejshme të dëshmitarit nga neni 392 i KPRK-së.

Dy norma janë në raport subsidiariteti kur njëra dispozitë (dispozita subsidiare) është e zbatueshme vetëm nëse nuk ka mundësi të zbatohet dispozita tjetër (dispozita parësore) dhe vendoset për ta mbuluar atë situatë. Parimi i subsidiaritetit mund të parashihet shprehimisht me ligj apo të lihet i nënkuptuar. Shembuj: përgjegjësia penale e kryeredaktorit të një publikimi në media sipas nenit 37 të KPRK-së është shprehimisht subsidiare ndaj përgjegjësisë së përgjithshme penale të të njëjtin person (neni 39 i KPRK-së); babai i cili me qëllim të mbytjes së djalit të tij të vogël e braktis në një situatë të rrezikshme dhe e lë të vdesë, kryen vrasje të rëndë nga neni 179.1.1 i KPRK-së dhe jo veprën penale të braktisjes së personave të paaftë nga neni 192.1 i KPRK-së për shkak se mbrojtja ligjore e vetë rrezikut nënkuptohet se është subsidiare ndaj mbrojtjes së rezultatit praktik të atij rreziku.

Dy norma janë në raport të alternativës kur më shumë sesa një përshkrim juridik mund t’i shkojë një veprimi por ka një përshkrim i cili predominon ndaj tjetrit – ky është rasti i veprave penale të cilat mund të kryhen me shumë veprime alternative. Shembull: personi që e nis një zjarr dhe e shkakton një shpërthim për dëmtimin e pronës së personit tjetër kryen vetëm një veprë penale të zjarr-vënies (neni 334 i KPRK-së) edhe veprimi i këtij kryerësi i ka përmbushur të dyja veprimet tipike.

Në fund fare, dy norma janë në raport konsumimi kur njëra prej dispozitave (dispozita absorbuese) përmban elemente të normës tjetër më pak të rëndë (dispozitës së absorbuar). “Parimi i veprës më të lehtë të përfshirë” nënkupton se vepra penale më e lehtë e plotëson dhe i ndihmon kryerjes së veprës më të rëndë penale. Shembull: kryerësi i cili e kërcënon një person tjetër në një prej formave të përcaktuara me nenin 185.1 të KPRK-së me qëllim të detyrimit (zhvatjes) së viktimës, e kryen veprën penale të detyrimit nga neni 340 i KPRK-së dhe jo dy vepra – në këtë situatë veprimi më pak i rëndë i kërcënimit mjet ndihmues i veprimit më të rëndë të detyrimit. Normalisht kur normat janë në raport të konsumimit, dënimi i përcaktuar për normën absorbuese është më i madh sesa dënimi i paraparë për normën e absorbuar. Por në disa situata ndodh e kundërta dhe dënimi i zbatuar për veprimin ndihmues është më i madh. Në ato raste, mbrojtja më e mirë e vlerës së shkelur e imponon që veprimi duhet patjetër të dënohet në bazë të dispozitës e cila përcakton një dënim më të madh. Shembull: kryerësi i cili, për ta kryer mashtrimin, e shfrytëzon dokumentin publik të falsifikuar si mjet për ta mashtruar viktimën, i nënshtrohet dënimit të përcaktuar me nenin 398.2 dhe jo dënimin të përcaktuar me nenin 335.1

të KPRK-së. Në rastin konkret, veprimi i absorbuar është më i madh sesa veprimi absorbues prandaj logjikisht “parimi i veprës më të lehtë të përfshirë” nuk është i zbatueshëm.

Duke pasur koncepte të tilla në mendje, kolegji i apelit tash do të vërtetojë se cilat vepra penale janë kryer nga të pandehurit. Është thelbësore të përkufizohet shtrirja e secilës vepër si dhe kufijtë në mes tyre.

*Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 316. 1 dhe 3 i KPK-së) përbëhet nga pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare të sigurisë publike, urdhrit apo punëve policore duke përdorur forcën apo kërcënimin me përdorim të menjëhershëm të forcës dhe është vepër e dënueshme prej 3 muaj deri në 3 vjet<sup>24</sup>. Kjo dispozitë i mbulon situatat në të cilat ka prova rreth veprimeve konkrete individuale të kryerësit. Vepra penale *pjesëmarrje në grup për pengimin e personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* (neni 318.1 i KPK-së) përmban pjesëmarrjen në një veprim të përbashkët të grupit me qëllim të pengimit apo tentativës për pengimin e personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare apo detyrimin e tij / saj në kryerjen e detyrave zyrtare dhe është vepër e dënueshme me gjobë apo burgim prej deri në 3 vjet<sup>25</sup>. Kjo dispozitë i mbulon situatat kur ekzistojnë provat se kryerësi ka qenë në grup dhe ka marrë pjesë në veprimet e përbashkëta, por nuk është e mundur të vërtetohen veprimet konkrete individuale të pengimit të cilat janë kryer nga ana e tij / saj. Shpjegimi i arsyeshëm prapa dënimit më të vogël për veprimet të cilat synojnë të njëjtin rezultat me shkeljen e vlerës së njëjtë të mbrojtur qëndron në faktin se pesha e veprës është më e ulët kur nuk provohet se kryerësi nuk i ka kryer veprimet konkrete kundër organit publik. Kolegji i apelit konstaton se këto dispozita janë në raportin e bashkimit ideal në formën e subsidiaritetit të nënkuptuar. Vepra më e lehtë është subsidiare në situatat kur nuk vërtetohet vepra më e rëndë.

Për këtë arsye, kolegji i apelit është i mendimit se dënimi për të dyja veprat penale, siç është vendosur nga kolegji i apelit, nuk do të ishte i pranueshëm për shkak se ato nuk janë në raportin e bashkimit real. Për më tepër, pavarësisht pohimit të mësipërm, dënimi për veprën penale të përmendur pengim i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, në pikëpamjen e kolegjit të apelit, duhet t’ia lëshojë udhën ekzistimit të veprës penale e cila është e veçantë lidhur me këtë.

Vepra penale *rrezikim i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to* (neni 142.2 i KPK-së) përmban angazhimin në sulmin ndaj personit apo lirisë së personelit të Kombeve të Bashkuara apo personelit në marrëdhënie me to dhe është vepër e dënueshme me burgim prej 1 deri në 10 vjet<sup>26</sup>. Kur ky sulm rezulton me vdekjen e një a më shumë personave, dënimi është së paku 5 vjet burgim (par. 5 i nenit të njëjtë<sup>27</sup>), në qoftë se

---

<sup>24</sup> Dispozita përkatëse në ligjin e tanishëm është neni 409.5 i KPRK-së ndërsa dënimi është burgim prej 1 deri në 5 vjet.

<sup>25</sup> Dispozita përkatëse në ligjin e tanishëm është neni 409.2 i KPRK-së ndërsa dënimi është i njëjtë.

<sup>26</sup> Dispozita përkatëse në ligjin e tanishëm është neni 174.2 i KPRK-së ndërsa dënimi është burgim me 3 deri në 12 vjet.

<sup>27</sup> Në këtë rast, neni 174.4 i KPRK-së parasheh dënim prej më së paku 10 vjet burgim.

vdekja mund t'i atribuohet pakujdesisë së kryerësit, në përputhje me nenin 17 të KPK-së<sup>28</sup>. Ligji nuk e përkufizon “sulmin” por një koncept i tillë i përfshin të gjitha veprimet e dhunës fizike, përdorimit të forcës apo kërcënimit i cili i prek personat apo lirinë e viktimave dhe padyshim i përfshin të gjitha veprimet e parashikuara në veprën penale pengim i personave zyrtarë që kryejnë detyrat zyrtare. Ligji po ashtu nuk e sqaron shprehimisht se rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara i mbulon vetëm situatat kur viktimat janë duke i kryer detyrat zyrtare, por një konkluzion i tillë rezulton nga përkufizimet e paragrafit 6 të nenit të referuar 142. Këto dy veprat penale *pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* si dhe *rrezikim i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to* janë në raport të bashkimit ideal në formën e specialitetit. Të dyja synojnë mbrojtjen e personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare prej veprimeve të dhunshme dhe kërcënuese. Por e dyta bart në vete një element të posaçëm i cili nuk është i pranishëm në veprën e parë, e ky element është karakteri specifik ndërkombëtar i disa prej personave zyrtarë, si rezultat i të cilit kjo vepër është më e rëndë.

Duke e pasur parasysh faktin se është provuar se polici ka vdekur si rezultat i plagëve të shkaktuara nga ky sulm në të cilin të gjithë të pandehurit kanë qenë të përfshirë dhe se ata kanë qenë në dijëni rreth rrezikut i cili ka mundur të ndodhë, vepra penale *rrezikim i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to* gjithashtu e absorbon edhe veprën penale *pjesëmarrje në grup që kryen vepra penale* (neni 320.1 i KPK-së), për të cilën të pandehurit ishin dënuar njëkohësisht. Kjo vepër penale përmban pjesëmarrjen në turmën e tubuar e cila përmes veprimit kolektiv e privon nga jeta personin tjetër dhe si e tillë është vepër e dënueshme me burgim prej 3 muaj deri në 5 vjet<sup>29</sup>.

Edhe kësaj radhe në një situatë të tillë nuk ka nevojë për asnjë provë të veprimit individual konkret të kryerësit. Kolegji i apelit konstaton se këto dy dispozita ligjore janë në raport të bashkimit ideal në format (modalitetet) e subsidiaritetit të nënkuptuar dhe specialitetit, për arsye të ngjashme me ato që u përmendën më sipër. Ngarkimi me veprimet kolektive të turmës është subsidiar (plotësues) me ngarkimin me veprimet individuale konkrete të provuara të kryerësit. Fajësimi me sulmin i cili e shkakton vdekjen e personit të Kombeve të Bashkuara apo personelit në marrëdhënie me to është i veçantë në raport me fajësimin për veprimin kolektiv i cili ka shkaktuar vdekjen e një personi tjetër.

Kolegji i apelit prandaj e vërteton se cilësimi i drejtë juridik i zbatueshëm për faktet e vërtetuara nga gjykata e shkallës së parë është se të pandehurit janë përfshirë në veprën penale rrezikim i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to, vepër kjo e dënueshme me 5 deri në 10 vjet, në bazë të nenit 142 (2) dhe (5) të KPK-së<sup>30</sup>. Kjo është

---

<sup>28</sup> Për privim të qëllimshëm nga jeta, vepra penale është vepra nën paragrafin 1 të këtij neni.

<sup>29</sup> Dispozita përkatëse në ligjin e tanishëm është neni 412.1 i KPRK-së ndërsa dënimi është burgim prej 6 muaj deri në 5 vjet.

<sup>30</sup> KPK-ja është më e favorshme sesa KPRK-ja për arsye se ky kod parasheh burgim prej më së paku 10 vjetësh.

dispozita ligjore e cila në mënyrën më të plotë dhe më efektive e përmbledh dhe e sanksionon tërësinë e gabueshmërisë së veprimeve penale të kryerësit.

Kolegji i apelit tani përballlet me një situatë të pazakonshme dhe në njëfarë mënyre të palakmueshme e cila kërkon vëmendjen tonë.

Gjykata e Apelit konstaton se është cilësuar drejt vepra penale e kryer nga të pandehurit si vepër e cila është e dënueshme me burgim prej 5 deri në 10 vjet. Për veprat penale të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, të pandehurit janë dënuar me dënime unike shumë më të lehta prej 1 viti e 10 muaj burgim, me 9 muaj burgim dënim të kushtëzuar për 1 vit dhe me 1 vit e 6 muaj burgim. Gjykata e Apelit në përgjithësi ka të drejtë ta ndryshojë *ex officio* cilësimin juridik të fakteve. Po ashtu, ajo mund t'i rrisë dënimet nëse është duke e vendosur ankesën e prokurorisë. Në këtë rast, megjithatë, për shkak të faktit se po vendoset vetëm lidhur me ankesat në favor të të akuzuarit, ashpërsimi i dënimeve nuk është i pranueshëm. Kjo do të rezultonte në shkeljen e nenit 417 të KPP-së i cili e ndalon parimin *reformation in pejus*, d.m.th. ndryshimin e aktgjykimit përkitazi me cilësimin juridik dhe sanksionin penal në dëm të të pandehurve.

Gjykata e Apelit po ashtu nuk është e autorizuar ta anulojë aktgjykimin dhe ta kthejë lëndën në rigjykim pranë gjykatës së shkallës së parë për shkak se nuk është bërë asnjë shkelje esenciale e procedurës, qoftë ajo shkelje e pohuar nga palët apo shkelje e cila shqyrtohet *ex officio* (sipas nenit 415 të KPP-së). Edhe në qoftë se shkelja esenciale procedurale ka ndodhur, kolegji i apelit është i bindur se në mungesë të ankesës valide nga prokuroria, anulimi në dëm të të akuzuarit do të ishte i kontestueshëm, për shkak të parimit të përcaktuar në nenin 424 (2) të KPP-së<sup>31</sup>.

Siç mund të shihet nga lart, nuk ka pasur asnjë shkelje esenciale të procedurës dhe aktgjykimi është i vlefshëm. Mendimi i kolegjit të apelit është se ligji material nuk është zbatuar drejt në shkallën e parë. Por në mungesë të ankesës nga prokuroria, ndalohet ndryshimi i aktgjykimit në dëm të të akuzuarit. Prandaj, kolegji i apelit nuk ka alternativë tjetër pos ta vërtetojë aktgjykimin përkitazi me cilësimin juridik të veprave penale.

#### **6.4 Vërtetimi i gabueshëm i dënimit**

Ankuesit M.I. dhe D.M. e kanë kontestuar vërtetimin e dënimeve duke i konsideruar ato si shumë të ashpra. Shkurtimisht, ankuesi i parë pretendon se trupi gjykues nuk i ka vlerësuar si rrethana lehtësuese: familjen e tij, gjendjen ekonomike dhe shëndetësore dhe se nuk ka mundur të vlerësohet si rrethanë rënduese dëmi material të cilin ai nuk e ka shkaktuar, dhe roli i tij në ngjarjet e 14 marsit për të cilin ai nuk është dënuar. Ankuesi i dytë pretendon se trupi gjykues i ka injoruar rrethanat lehtësuese që lidhen me moshën e tij të re, gjendjen ekonomike dhe profesionale dhe mungesën e dënimeve të mëhershme.

---

<sup>31</sup> Kjo dispozitë mbulon një situatë tjetër por parimi i mbrojtur aty është pjesë e parimit të gjykimit drejtë. Duke vepruar *ex officio* për anulimin e aktgjykimit të cilin prokuroria nuk e kontestuar në mënyrë të lejuar në dëm të të akuzuarit ngre çështjen e drejtësisë dhe efektivitetit të të drejtave të mbrojtjes.



Në bazë të dispozitave të neneve 34 dhe 64 deri më 71 të KPK-së, parimet e zbatueshme të drejtësisë dhe proporcionalitetit dhe qëllimit shoqëror të ligjit penal, rregullat për matjen e dënimit janë këto:

- Sanksioni penal është masa e fundit për mbrojtjen e vlerave shoqërore dhe nuk mund të ndërhyjë përtej asaj që konstatohet si patjetër e domosdoshme. Sanksioni nuk guxon të jetë më i lartë sesa domosdoshmëria e zbatimit të drejtësisë dhe në shpërpjesëtim me faktin i cili i ka rrezikuar vlerat e mbrojtura shoqërore. Për këtë arsye, parimi i ndërhyrjes minimale të ligjit penal nënkupton se dënimi i ulët i paraparë në dispozitë, do të ishte i mjaftueshëm, adekuat dhe normal për situatat standarde të cilat mund të konsumohen në inkriminimin juridik;
- Dënimi lidhet me qëllimet e sigurimit të parandalimit dhe rehabilitimit individual si dhe parandalimit të përgjithshëm, duke e shprehur mosmiratimin shoqëror për shkeljen e vlerave të mbrojtura shoqërore dhe duke e përforcuar respektin e shoqërisë ndaj ligjit;
- Gjatë caktimit të dënimit, dënimi i aplikuar maksimal i zbatueshëm në rastin konkret do të shqiptohet sipas shkallës së fajit të kryerësit dhe ai minimal në bazë të nevojave për mosmiratimin e veprës nga shoqëria. Brenda këtij kufiri të ri, sanksioni në fjalë nuk guxon të jetë në kundërshtim me parimet e referuara të parandalimit dhe të rehabilitimit dhe duhet të marrë parasysh të gjitha rrethanat konkrete lehtësuese dhe rënduese të cilat lidhen me faktin kriminal dhe me sjelljen dhe rrethanat personale dhe shoqërore të kryerësit të veprës;

Siç u tha më lart, përshtatshmëria e dënimeve do të vlerësohet në raport me veprat penale më të lehta për të cilat të pandehurit janë dënuar dhe jo për atë më të rëndën për të cilën sipas mendimit të kolegjit të apelit është dashur të dënohen. Kjo gjë nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë në vendimin – pasi që aktgjykimi nuk mund të ndryshohet në dëm të të pandehurit – por kjo gjë përmendet për ta theksuar se për shkak të ankesës së paafatshme të prokurorisë dhe ndikimit të saj – çfarëdo qoftë ai – në epilogun përfundimtar, ankuesit nuk mund të ankohen në asnjë mënyrë se gjykata ka qenë tepër e ashpër<sup>32</sup>.

Kolegji i apelit, gjatë shqyrtimit të dënimeve është e kufizuar me gjendjen faktike të vërtetuar në aktgjykim dhe me vlerësimin e rregullave ligjore në fuqi për caktimin e dënimit. Kolegji nuk është i lidhur me peshën specifike të cilën trupi gjykues ia ka dhënë secilës rrethanë rënduese apo lehtësuese. Faktet tjera të supozuara në favor të të pandehurve por jo fakte të vërtetuara nga trupi gjykues nuk mund të shqyrtohen tani për caktimin e dënimit. Nëse ankuesit kanë dashur të sjellin fakte të reja për t'u vërtetuar ata është dashur t'i pohojnë provat nga të cilat dalin këto fakte dhe të kërkojnë nga Gjykata e Apelit që t'i vërtetojë ato fakte. Meqenëse ata nuk e kanë bërë një gjë të tillë ndërsa roli i kolegjit të apelit nuk është të hulumtojë *ex officio* provat në kërkim të fakteve të reja në favor të cilësdo palë.

M.I. është dënuar me burgim prej 6 muajsh për veprën penale nga neni 316.3 që përcakton dënimin nga tre muaj deri në 5 vjet, me 4 muaj për veprën penale nga neni 318.1 që përcakton dënimin deri në 3 vjet, me 6 muaj për veprën penale nga neni 320.1 që përcakton dënimin prej 3

---

<sup>32</sup> I pandehuri Z.Č., dënimi i të cilit nuk është kontestuar prandaj si i tillë nuk mund të rishikohet, ka qenë madje i dënuar me 8 muaj burgim për veprën penale nga neni 142.2 i KPK-së i cili përcakton dënim minimal prej 1 viti.

muajsh deri në 5 vjet dhe me 1 vit e 6 muaj për veprën penale nga neni 142.2 që përcakton dënimin nga 1 deri në 10 vjet burgim. Si dënim unik, nga dënimi minimal prej 1 vit e 6 muaj deri tek dënimi maksimal prej 2 vjet e 10 muaj burgim, ai është dënuar me 1 vit e 10 muaj.

D.M. për të njëjtat vepra penale është dënuar me burgim prej 4 muajsh, 2 muajsh, 4 muajsh dhe 1 vit e 6 muaj. Si dënim unik, midis dënimit minimal prej 1 viti e 6 muajsh dhe dënimit maksimal prej 2 vjet e 4 muajsh, ai është dënuar me 1 vit e 6 muaj.

Kolegji i apelit, si vërejtje fillestare, e gjen të përshtatshme të theksojë se pasi që të pandehurit ishin të dënuar me afate burgimi shumë afër afateve minimale të zbatueshme nuk mund të kuptohet atëherë arsyeja si ata mund të pretendojnë dënime edhe më të buta.

I pandehuri M.I. thekson se familja e tij, gjendja ekonomike dhe gjendja shëndetësore nuk janë marrë parasysh. Trupi gjykues ka marrë parasysh gjendjen e tij prej një burri të ve, mungesën e dënimeve të mëhershme dhe vullnetin e tij për t'u bërë qytetar i mirë. Asnjë fakt nuk është vërtetuar lidhur me aspektet e tjera të jetës së të pandehurit të cilin kolegji i apelit do të mund ta vlerësonte tani. Ai pohon se dëmi material i shkaktuar në ngjarjet në fjalë dhe roli i tij më 14 mars janë vlerësuar gabimisht si rrethana rënduese. Kolegji i apelit konstaton se ai nuk ka të drejtë. Intensiteti i shkeljes së vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat vepra është kryer si dhe sjellja në të kaluarën e kryerësit janë elemente të cilat trupi gjykues do të duhej t'i shqyrtonte sipas nenit 64 të KPP-së. Vlerësimi i drejtë i dënimit nuk ka mundur ta injoronte rezultatin e veprimeve të grupit në të cilat ky i pandehur ka marrë pjesë qëllimisht. Fakti se ai nuk është dënuar për asnjë krim të kryer më 14 mars nuk e pengon shqyrtimin e veprimeve të tija për arsye se ato janë pjesë e sjelljes së tij në të kaluarën dhe drejtpërdrejt kanë ndikim në peshën e veprimeve të tij më 17 mars.

D.M. pretendon se janë injoruar rrethanat lehtësuese të moshës së tij të re, të gjendjes ekonomike dhe profesionale dhe mungesës së dënimeve më të hershme. Trupi gjykues e ka vlerësuar qëllimin e tij për t'u martuar së shpejti, dëshirën e tij për t'u integruar në shoqëri si qytetar i mirë, moshën e tij të re kur ishin kryer krimet në fjalë. Asnjë fakt tjetër nuk është vërtetuar lidhur me aspektet e ndryshme të jetës personale të të pandehurit të cilin kolegji i apelit do të mund ta vlerësonte tani.

Kolegji i apelit konstaton si konkluzion se brenda afateve të dënimeve të dhëna me burgim për veprat penale të konstatuara nga trupi gjykues dhe duke pasur parasysh kushtet ligjore të zbatueshme, ankuesit nuk kanë qenë bindës se dënimet në fjalë duhet të ulen.

## **7. Konkluzionet**

Ankesa e prokurorisë është e paafatshme dhe nuk mund të shqyrtohet. Kjo rrethanë i pengon kolegjit të apelit për t'i vlerësuar arsyet e pohuara nga prokurori me qëllim të vërtetimit si të provuar të çfarëdo fakti në dëm të të pandehurve. Si pasojë e kësaj, qëllimi i saj për kthimin prapa të vendimit për lirim të të pandehurve M.R., A.K. dhe N.J. dhe rritje të dënimeve të

shqiptuara kundër të pandehurve M.I., Z.C. dhe D.M. nuk është adresuar nga ana e Gjykatës së Apelit.

Nuk është konstatuar asnjë shkelje esenciale procedurale e cila do të përcaktonte anulimin e aktgjyimit dhe kthimin e lëndës në rigjykim.

Nuk është gjetur asnjë gabim apo lëshim lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike.

Kolegji i apelit ka konstatuar se vepra penale e kryer nga të pandehurit M.I., Z.C. dhe D.M. ka qenë *Rrezikim i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to* e cila është vepër e dënueshme me burgim prej 5 deri në 10 vjet, në bazë të nenit 142 (2) dhe (5) të KPK-së. Megjithatë, për shkak të faktit se në mungesë të ankesës së prokurorisë Gjykatës së Apelit nuk i lejohet ta ndryshojë cilësimin juridik të veprës në dëm të të pandehurve, është vendosur të vërtetohet po ai cilësim juridik për të cilin ishte vendosur në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Ankesat e mbrojtjes me të cilat është kërkuar lirimi apo ulja e dënimeve kanë qenë të pabaza.

Kryetar i kolegjit

---

Manuel Soares, gjyqtar i EULEX-it

Anëtar i kolegjit

---

Tore Thomassen, gjyqtar i EULEX-it

Anëtar i kolegjit

---

Driton Muharremi, gjyqtar i Gjykatës së Apelit

Procesmbajtëse

---

Kerry Moyes, zyrtare ligjore e EULEX-it

